



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.84

19 qershor

2011

P Ë R M B A J T J A

Udhëzim i MPPT
nr.11, datë 6.6.2011

Për miratimin e tipit të mjeteve motorike dhe rimorkiove të
tyre, të sistemeve, pjesëve përbërëse dhe njësive të veçanta
teknike të destinuara për këto mjete.....

Faqe

3415

UDHËZIM
Nr.11, datë 6.6.2011

**PËR MIRATIMIN E TIPIT TË MJETEVE MOTORIKE DHE RIMORKIOVE TË TYRE, TË
SISTEMEVE, PJSËVE PËRBËRËSE DHE NJËSIVE TË VEÇANTA TEKNIKE TË
DESTINUARA PËR KËTO MJETE**

Në mbështetje të pikës 4, neni 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenit 71, 72, 74 75 dhe 76 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; nenit 223, 224, 225, 226, 227, 228, 230, 232 dhe 233 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.153, datë 7.4.2000 “Rregullorja e zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; direktivës 2007/46/KE, datë 5.9.2007 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit “Për miratimin e mjeteve motorike dhe rimorkiove të tyre, dhe të sistemeve, pjesëve përbërëse dhe njësive të veçanta teknike të destinuar për këto mjete” dhe të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit midis Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane dhe shteteve të tyre anëtare, protokollit 5 “Mbi transportin tokësor”, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit

UDHËZON:

KAPITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Udhëzimi transponon direktivën 2007/46/KE në legjislacionin shqiptar dhe vendos një kuadër të harmonizuar që përmban dispozita administrative dhe kërkesa të përgjithshme teknike për miratimin e tipit të të gjitha mjeteve të reja brenda fushës së zbatimit të saj dhe të sistemeve, pjesëve përbërëse dhe njësive të veçanta teknike të destinuar për ato mjete, me qëllim lehtësimin e regjistrimit, shitjes dhe hyrjes së tyre në shërbim brenda Komunitetit.

Udhëzimi vendos, gjithashtu, dispozita për shitjen dhe hyrjen në shërbim të pjesëve dhe pajisjeve të destinuar për mjetet e miratuara sipas direktivës 2007/46/KE.

Kërkesa specifike teknike në lidhje me ndërtimin dhe funksionimin e mjeteve në zbatim të këtij udhëzimi, në harmoni të plotë me direktivën 2007/46/KE, parashikohen në aktet rregullatore, lista e të cilëve është parashikuar në shtojën IV.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Ky udhëzim, në harmoni të plotë me direktivën 2007/46/KE, zbatohet për miratimin e tipit të mjeteve të destinuar dhe ndërtuara në një ose më shumë faza për përdorim në rrugë dhe të sistemeve, pjesëve përbërëse dhe njësive të veçanta teknike të projektuara dhe ndërtuara për këto mjete.

Ai zbatohet, gjithashtu, për miratimin individual të këtyre mjeteve.

Ky udhëzim zbatohet edhe për pjesët dhe pajisjet e destinuar për mjetet e mbuluara nga direktiva 2007/46/KE.

2. Ky udhëzim, në harmoni të plotë me direktivën 2007/46/KE, nuk zbatohet për miratimin e tipit ose miratimin individual të mjeteve të mëposhtme:

a) traktorët bujqësorë dhe pylltarinë, sipas përkufizimit në direktivën 2003/37/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të datës 26 maj 2003 mbi miratimin e tipit të traktorëve bujqësorë dhe të pylltarisë, rimorkiove të tyre dhe makineritë e rimorkiueshme dhe të këmbyeshme, së bashku me sistemet, pjesët përbërëse të tyre dhe njësitë teknike të veçanta dhe rimorkiove të projektuara dhe ndërtuara enkas që të rimorkiohen prej tyre;

b) katërrotëshat sipas përkufizimit në direktivën 2002/24/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të datës 18 mars 2002 në lidhje me miratimin e tipit të mjeteve me dy ose tri rrota;

c) mjetet me zinxhirë.

3. Miratimi i tipit ose qëndrimi individual sipas këtij udhëzimi, në harmoni të plotë me direktivën 2007/46/KE, është fakultativ për mjetet e mëposhtme:

a) mjetet e projektuara dhe ndërtuara për t'u përdorur kryesisht në kantierë ndërtimi ose në gurore, ambiente portuale apo aeroportuale;

b) mjetet e projektuara dhe të ndërtuara për t'u përdorur nga shërbimet e armatosura, mbrojtja civile, shërbimet kundër zjarrit dhe forcat përgjegjëse për ruajtjen e qetësisë publike; dhe

c) makineritë e lëvizshme, në masën që këto mjete përmbushin kërkesat e direktivës 2007/46/KE. Këto miratime fakultative nuk cenojnë zbatimin e direktivës 2006/42/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit të datës 17 maj 2006 mbi makineritë.

4. Një miratim individual sipas këtij udhëzimi, në harmoni të plotë me direktivën 2007/46/KE, është fakultativ për mjetet e mëposhtme:

a) mjetet e destinuara përjashtimisht për gara në rrugë;

b) prototipat e mjeteve të përdorura në rrugë nën përgjegjësinë e një prodhuesi që kryen një program testimi specifik, me kusht që ato të jenë projektuar enkas dhe ndërtuar për këtë qëllim.

Neni 3 Përkufizime

Për qëllimet e këtij udhëzimi, në harmoni të plotë me direktivën 2007/46/KE, dhe të akteve rregullatore të renditura në shtojcën IV, përveç kur atje parashikohet ndryshe:

1. "Akt rregullator" është një direktivë ose rregullore e veçantë ose një rregullore UNECE bashkangjitur Marrëveshjes së Rishikuar të vitit 1958.

2. "Direktivë ose rregullore e veçantë" është një direktivë ose rregullore e renditur në pjesën I të shtojcës IV. Ky term përfshin edhe aktet e tyre zbatuese.

3. "Miratim i tipit" është procedura, nëpërmjet së cilës një shtet anëtar certifikon që një tip mjeti, sistemi, pjesë përbërëse ose njësi teknike e veçantë përmbush dispozitat përkatëse administrative dhe kërkesat teknike.

4. "Miratim i tipit kombëtar" është një procedurë miratimi i tipit i parashikuar në ligjin e brendshëm të një shteti anëtar; vlefshmëria e një miratimi të tillë është e kufizuar në territorin e atij shteti anëtar.

5. "Miratim i tipit KE" është procedura nëpërmjet së cilës një shtet anëtar certifikon që një tip mjeti, sistemi, pjesë përbërëse apo njësi teknike e veçantë përmbush dispozitat përkatëse administrative dhe kërkesat teknike të direktivës 2007/46/KE, dhe të akteve rregullatore të renditura në shtojcën IV dhe XI.

6. "Qëndrim individual" është procedura, nëpërmjet së cilës një shtet anëtar certifikon që një mjet i caktuar, qoftë unik apo jo, përmbush dispozitat përkatëse administrative dhe kërkesat teknike.

7. "Miratim i tipit me disa faza" është procedura, nëpërmjet së cilës një ose më shumë shtete anëtare, në varësi të gjendjes së kompletimit, një tip i pakompletuar ose i kompletuar mjeti përmbush dispozitat përkatëse administrative dhe kërkesat teknike të direktivës 2007/46/KE.

8. "Miratim i tipit hap pas hapi" është një procedurë miratimi për mjetin që përbëhet nga mbledhja hap pas hapi e të gjithë kompletit të certifikatave të miratimit të tipit KE për sistemet, pjesët përbërëse dhe njësitë e veçanta teknike në lidhje me mjetin, dhe që, në fazën përfundimtare, çon në miratimin e të gjithë mjetit.

9. "Miratim mjeti me një fazë" është procedura që konsiston në miratimin e një mjeti si i tërë nëpërmjet një veprimi të vetëm.

10. "Miratim i tipit i përzier" është procedura e miratimit të tipit hap pas hapi për të cilin një ose disa miratime të sistemit arrihen në fazën e fundit të miratimit të të gjithë mjetit, pa qenë e nevojshme të lëshohet një certifikatë miratimi i tipit KE për ato sisteme.

11. "Mjet motorik" është çdo mjet me konsum energjie që lëviz vetë, që ka të paktën katër rrota, i plotë, i kompletuar ose jo, me një shpejtësi maksimale të projektuar që kalon 25 km/orë.

12. "Rimorkio" është çdo mjet jovetëllëvizës mbi rrota që është i projektuar dhe ndërtuar të rimorkiohet nga një mjet motorik.

13. “Mjet” është një mjet motorik ose rimorkioja e tij sipas përkufizimit në pikat 11 dhe 12.
14. “Mjet motorik hibrid” është një mjet me të paktën dy konvertues energjie të ndryshëm dhe dy sisteme të ndryshme ruajtje energjie (në mjet) për qëllimet e lëvizjes së mjetit;
15. “Mjet elektrik hibrid” është një mjet hibrid që, për qëllimet e lëvizjes mekanike, tërheq energji nga të dyja burimet në mjet të energjisë/fuqisë së ruajtur:
- një karburant të konsumueshëm;
 - një pajisje për ruajtjen e energjisë elektrike/fuqisë (p.sh.: bateri, kondensator, volant/gjenerator etj.).
16. “Makineri e lëvizshme” është një mjet vetëlëvizës që është i projektuar dhe ndërtuar specifikisht për të kryer punë që, për shkak të karakteristikave të ndërtimit të tij, nuk është i përshtatshëm për të transportuar pasagjerë ose për transportimin e mallrave. Makinaria e montuar në një shasi të mjetit motorik nuk konsiderohet si makineri e lëvizshme.
17. “Tip mjeti” janë mjetet e një kategorie të caktuar që nuk ndryshojnë të paktën në aspektet thelbësore të përcaktuara në seksionin B të shtojcës II. Një tip mjeti mund të përmbajë variante dhe versione sipas përkufizimit në seksionin B të shtojcës II.
18. “Mjet bazë” është një mjet që përdoret në fazën fillestare të një procesi miratimi të tipit me shumë faza.
19. “Mjet i pakompletuar” është çdo mjet që duhet të kalojë të paktën një fazë tjetër të kompletimit, me qëllim që të përmbushë të kërkesat teknike përkatëse të direktivës 2007/46/KE;
20. “Mjet i kompletuar” është një mjet që rrjedh nga procesi i miratimit të tipit me shumë faza, që përmbush kërkesat përkatëse teknike të direktivës 2007/46/KE.
21. “Mjet i plotë” është çdo mjet që nuk është e nevojshme të kompletohet, me qëllim që të përmbushë kërkesat teknike të direktivës 2007/46/KE.
22. “Mjet i fundit të serive” është çdo mjet që është pjesë e një gjendjeje që nuk mund të regjistrohet apo shitet, apo të vihet në shërbim për shkak të hyrjes në fuqi të kërkesave të reja teknike sipas të cilave ai nuk është i miratuar.
23. “Sistem” është një komplet pajisjesh të kombinuara për të kryer një ose disa funksione specifike në një mjet dhe që u nënshtrohet kërkesave të një prej akteve rregullatore.
24. “Pjesë përbërëse” është një pajisje që u nënshtrohet kërkesave të një akti rregullator dhe që është caktuar të jetë pjesë e një mjeti, që mund të jetë miratuar si tip veçmas nga mjeti, nëse akti rregullator e parashikon shprehimisht këtë gjë.
25. “Njësi e veçantë teknike” është një pajisje që u nënshtrohet kërkesave të një akti rregullator dhe që është caktuar të jetë pjesë e një mjeti, që mund të jetë miratuar si tip veçmas, por vetëm në lidhje me një ose më shumë tipa të specifikuar të mjeteve, nëse akti rregullator e parashikon shprehimisht këtë gjë.
26. “Pjesë ose pajisje origjinale” janë pjesët ose pajisjet që prodhohen në pajtim me specifikimet dhe standardet e prodhimit të parashikuara nga prodhuesi i mjetit për prodhimin e pjesëve ose pajisjeve për montimin e mjetit në fjalë. Kjo përfshin pjesët dhe pajisjet që prodhohen në të njëjtën linjë prodhimi ose këto pjesë ose pajisje. Nëse nuk vërtetohet e kundërta, prezumohet që pjesët përbëjnë pjesë origjinale nëse prodhuesi i pjesës certifikon që pjesët përputhen me cilësinë e pjesëve përbërëse të përdorura për montimin e mjetit në fjalë dhe janë prodhuar në pajtim me specifikimet dhe standardet e prodhimit të prodhuesit të mjetit.
27. “Prodhues” është personi ose subjekti që përgjigjet para autoritetit të miratimit për të gjitha aspektet e miratimit të tipit ose procesit të autorizimit dhe për sigurimin e përputshmërisë së prodhimit. Nuk është thelbësore që personi ose subjekti të përfshihet drejtpërdrejt në të gjitha fazat e ndërtimit të mjetit, sistemit, pjesës përbërëse apo njësisë së veçantë teknike që i nënshtrohet procesit të miratimit.
28. “Përfaqësues i prodhuesit” është një person fizik ose juridik në Komunitet, që është i emëruar rregullisht nga prodhuesi për ta përfaqësuar atë para autoritetit të miratimit dhe për të vepruar në emër të tij në çështjet e mbuluar nga direktiva 2007/46/KE, dhe nëse bëhet referencë në termin “prodhues”, duhet të kuptohet sikur tregon prodhuesin ose përfaqësuesin e tij.
29. “Autoritet miratimi” në Republikën e Shqipërisë është Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), në zbatim të Kodit Rrugor, me kompetencë për të gjitha aspektet e miratimit të një tipi mjeti, sistemi, pjesë përbërëse ose njësie e veçantë teknike, ose për miratimin individual të një mjeti; për procesin e autorizimit, për lëshimin dhe, sipas rastit, tërheqjen e

certifikatave të miratimit; për të vepruar si pikë kontakti për autoritetet e miratimit të shteteve anëtare të tjera; për projektimin e shërbimeve teknike dhe për të siguruar që prodhuesi i përmbush detyrimet e tij në lidhje me përputhshmërinë e prodhimit.

30. “Autoritet kompetent” në nenin 42 është autoriteti i miratimit ose një autoriteti i caktuar, apo një organ akreditimi që vepron në emër të tyre.

31. “Shërbim teknik” është një organizatë ose subjekt i emëruar nga autoriteti i miratimit të një shteti anëtar, si një laborator testimi për të kryer testet ose si një subjekt vlerësimi i përputhshmërisë për të kryer vlerësimin fillestar dhe teste apo inspektime të tjera, në emër të autoritetit të miratimit, nëse për vetë autoritetin e miratimit është e mundur të përmbushë këto funksione.

32. “Metodë e testimit virtual” janë simulimet në kompjuter, duke përfshirë llogaritjet që demonstronjë nëse një mjet, sistem, pjesë përbërëse apo një njësi e veçantë teknike përmbush kërkesat teknike të një akti rregullator. Për qëllime testimi, një metodë virtuale nuk kërkon përdorimin e një mjeti, sistemi, pjesë përbërëse apo njësie teknike të veçantë fizike.

33. “Certifikatë e miratimit të tipit” është dokumenti nëpërmjet të cilit autoriteti i miratimit certifikon zyrtarisht që miratohet një tip mjete, sistemi, pjesë përbërëse apo njësie teknike e veçantë.

34. “Certifikatë e miratimit të tipit KE” është certifikata e parashikuar në shtojcën VI ose në shtojcën përkatëse të një direktive apo rregulloreje të veçantë, ku formulari i komunikimit të parashikuar në shtojcën përkatëse të rregulloreve UNECE, të renditura në pjesën I ose pjesën II të shtojcës IV të direktivës 2007/46/KE, konsiderohet të jetë e barasvlershme me të.

35. “Certifikatë e miratimit individual” është dokumenti nëpërmjet të cilit autoriteti i miratimit certifikon zyrtarisht që miratohet një mjet i caktuar.

36. “Certifikatë përputhshmërie” është dokumenti i parashikuar në shtojcën IX, i lëshuar nga prodhuesi dhe që certifikon që mjeti që i përket serisë së tipit të miratuar në pajtim me direktivën 2007/46/KE, ka qenë në pajtim me të gjitha aktet rregullatore në kohën e prodhimit të tij.

37. “Dokument informacioni” është dokumenti i parashikuar në shtojcën I ose shtojcën III, ose në shtojcën përkatëse të një direktive apo rregulloreje të veçantë, që parashikon informacionin që duhet të jepet nga kërkuesi, ku është e lejueshme të jepet dokumenti i informacionit në formën e një dosjeje elektronike.

38. “Skedar informacioni” është skedari i plotë, duke përfshirë dokumentin e informacionit, dosjen, të dhënat, skicat, fotografitë etj., të dhëna nga kërkuesi, ku është e lejueshme të jepet dokumenti i informacionit në formën e një dosjeje elektronike.

39. “Paketë informacioni” është skedari i informacionit që shoqërohet nga raportet e testit dhe të gjitha dokumentet e tjera të shtuara nga shërbimi teknik ose nga autoriteti miratues në skedarin e informacionit në kuadër të përmbushjes së funksioneve të tyre, ku është e lejueshme të jepet paketa e informacionit në formën e një dosjeje elektronike.

40. “Indeksi i paketës së informacionit” është dokumenti që rendit përmbajtjen e paketës së informacionit, të numërtuar rregullisht ose të shënuar ndryshe për të identifikuar qartazi të gjitha faqet, ku formati i dokumentit duhet të jetë i tillë që të paraqesë një renditje të hapave pasues në menaxhimin e miratimit të tipit KE, veçanërisht datat e rishikimeve dhe përditësimit.

KAPITULLI II DETYRIME TË PËRGJITHSHME

Neni 4

Detyrimet e DPSHTRR-së

1. DPSHTRR-ja siguron që prodhuesit që kërkojnë miratimin të respektojnë detyrimet e tyre sipas këtij udhëzimi, në harmoni të plotë me direktivën 2007/46/KE.

2. DPSHTRR-ja miraton vetëm ato mjete, sisteme, pjesë përbërëse ose njësi teknike të veçanta, që përmbushin kërkesat e këtij udhëzimi, në harmoni të plotë me direktivën 2007/46/KE.

3. DPSHTRR-ja regjistron ose lejon shitjen ose vënien në shërbim vetëm të atyre mjeteve, pjesëve përbërëse, dhe njërive teknike të veçanta që përmbushin kërkesat e këtij udhëzimi, në harmoni të plotë me direktivën 2007/46/KE.

DPSHTRR-ja nuk ndalon, kufizon apo pengon regjistrimin, shitjen, vënien në shërbim ose qarkullimin në rrugë të mjeteve, pjesëve përbërëse, dhe njësive teknike të veçanta për shkaqe të lidhura me aspektet e ndërtimit dhe funksionimit të tyre që mbulohen nga ky udhëzim, në harmoni të plotë me direktivën 2007/46/KE, nëse ato përmbushin kërkesat e kësaj të fundit.

4. DPSHTRR-ja është emëruar si autoritetet kompetent në çështjet në lidhje me miratimin e tipit të mjetit, për këtë Ministria e Punëve Publike dhe Transportit duhet të njoftojë Komisionin për këtë emërim, në pajtim me nenin 43.

Akti i njoftimit të autoriteteve të miratimit përfshin emrin, adresën, duke përfshirë adresën elektronike dhe zonën e tij të përgjegjësisë.

Neni 5

Detyrimet e prodhuesve

1. Prodhuesi është përgjegjës para autoritetit miratues për të gjitha aspektet e procesit të miratimit dhe për të siguruar përputhshmërinë e prodhimit, nëse prodhuesi është drejtpërdrejt i angazhuar apo jo në të gjitha fazat e ndërtimit të një mjeti, sistemi, pjesë përbërëse ose njësie teknike të veçantë.

2. Në rastin e miratimit të tipit me shumë faza, secili prodhues është përgjegjës për miratimin dhe përputhshmërinë e sistemeve, pjesëve përbërëse ose njësive teknike të veçanta të shtuara në fazën e kompletimit të mjetit të trajtuar prej tyre.

Prodhuesi që modifikon pjesët përbërëse ose sistemet tashmë të aprovuara në fazat e mëparshme është përgjegjës për miratimin dhe përputhshmërinë e prodhimit të atyre pjesëve përbërëse dhe sistemeve.

3. Për qëllimet e këtij udhëzimi, në harmoni të plotë me direktivën 2007/46/KE, një prodhues i themeluar jashtë Komunitetit emëron një përfaqësues të themeluar në komunitet për ta përfaqësuar atë para autoritetit të miratimit.

KAPITULLI III

PROCEDURAT E MIRATIMIT TË TIPIT KE

Neni 6

Procedurat që ndiqen për miratimin e tipit KE të mjeteve

1. Prodhuesi mund të zgjedhë një prej procedurave të mëposhtme:

- a) miratim tipi hap pas hapi;
- b) miratim tipi me një hap të vetëm;
- c) miratim tipi i përzier.

2. Një kërkesë për miratim tipi hap pas hapi përbëhet nga skedari i informacionit që përmban informacionin e kërkuar sipas shtojcës III, dhe shoqërohet nga tërësia e certifikatave të miratimit të tipit që kërkohen në pajtim me secilin akt rregullator të zbatueshëm, që është i renditur në shtojcën IV ose shtojcën XI. Në rastin e miratimit të tipit të një sistemi ose njësie teknike të veçantë, në pajtim me aktet rregullatore të zbatueshme, autoriteti i miratimit ka të drejtë të hyjë në paketën e informacionit deri në atë moment kur miratimi jepet apo refuzohet.

3. Një kërkesë për një miratim të tipit me një hap të vetëm përbëhet nga skedari i informacionit që kërkohet sipas shtojcës I, në lidhje me aktet rregullatore të përcaktuara në shtojcën IV ose shtojcën XI dhe, sipas rastit, në pjesën II të shtojcës III.

4. Në rastin e një procedure miratimi të tipit të përzier, autoriteti i miratimit mund të përjashtojë prodhuesin nga detyrimi për të paraqitur një ose më shumë certifikata të miratimit të tipit KE për sistemin, me kusht që skedari i informacionit të jetë i plotësuar me hollësi, të përcaktuara në shtojcën I, që kërkohen për miratimin e atyre sistemeve gjatë fazës së miratimit të mjetit, rast në të cilin secila prej certifikatave të miratimit të tipit KE prej të cilave është hequr dorë në këtë mënyrë zëvendësohen nga një raport testimi.

5. Pa cenuar paragrafët 2, 3 dhe 4, informacioni i mëposhtëm jepet për qëllimet e miratimit të tipit me shumë faza:

a) në fazën e parë, ato pjesë të skedarit të informacionit dhe certifikatat e miratimit të tipit KE të kërkuara për një mjet të plotë që janë të rëndësishme për fazën e kompletimit të mjetit bazë;

b) në fazën e dytë dhe ato pasuese, ato pjesë të skedarit të informacionit dhe certifikatat e miratimit të tipit KE që kërkohen për fazën e tashme të ndërtimit, së bashku me një kopje të certifikatës së miratimit të tipit KE për mjetin e lëshuar në fazën pararendëse të ndërtimit; përveç kësaj, prodhuesi jep hollësi të plota për çdo ndryshim ose shtesa që ai ka bërë në mjet.

Informacioni i specifikuar në pikat (a) dhe (b) mund të jepet në pajtim me procedurën e miratimit të përzier për tipin e përcaktuar në paragrafin 4.

6. Prodhuesi ia paraqet kërkesën autoritetit miratues. Vetëm një kërkesë mund të paraqitet në lidhje me një tip të caktuar mjeti dhe ajo mund të paraqitet vetëm në një shtet anëtar.

Një kërkesë e veçantë paraqitet për secilin tip që miratohet.

7. Autoriteti miratues, me kërkesë të arsyetuar, i kërkon prodhuesit të japë çdo informacion shtesë që kërkohet për të mundësuar një vendim që merret mbi ato teste që kërkohen ose për të lehtësuar ekzekutimin e atyre testeve.

8. Prodhuesi i ofron autoritetit miratues aq mjete sa janë të nevojshme për të mundësuar që procedura e miratimit të tipit të zhvillohet në mënyrë të pranueshme.

Neni 7

Procedura që ndiqet për miratimin e tipit KE të sistemeve, pjesëve përbërëse ose njësive teknike të veçanta

1. Prodhuesi ia paraqet kërkesën autoritetit miratues. Vetëm një kërkesë mund të paraqitet në lidhje me një tip të caktuar sistemi, pjese përbërëse ose njësie teknike të veçantë dhe ajo mund të paraqitet vetëm në një shtet anëtar. Një kërkesë e veçantë paraqitet për secilin tip që miratohet.

2. Kërkesa shoqërohet nga skedari i informacionit, përmbajtja e të cilit specifikohet në direktiva ose rregullore të veçanta.

3. Autoriteti miratues, me kërkesë të arsyetuar, i kërkon prodhuesit të japë çdo informacion shtesë që kërkohet për të mundësuar një vendim që merret mbi ato teste që kërkohen ose për të lehtësuar ekzekutimin e atyre testeve.

4. Prodhuesi i ofron autoritetit miratues aq mjete, pjesë përbërëse ose njësi teknike të veçanta që kërkohen sipas direktivave ose rregulloreve përkatëse të veçanta për realizimin e testeve të kërkuara.

KAPITULLI IV

ZHVILLIMI I PROCEDURAVE TË MIRATIMIT TË TIPIT KE

Neni 8

Dispozita të përgjithshme

1. DPSHTRR-ja, në harmoni të plotë me direktivën 2007/46/KE, nuk mund të japë asnjë miratim të tipit KE pa siguruar së pari që janë zbatuar në mënyrë të rregullt dhe të pranueshme procedurat e përmendura në nenin 12.

2. DPSHTRR-ja, në harmoni të plotë me direktivën 2007/46/KE, jep miratime të tipit KE në pajtim me nenet 9 dhe 10.

3. Nëse DPSHTRR-ja, në harmoni të plotë me direktivën 2007/46/KE, konstaton që një tip mjeti, sistemi, pjese përbërëse apo njësie teknike e veçantë, megjithëse në pajtim me dispozitat e kërkuara, paraqet një rrezik serioz për sigurinë rrugore ose dëmton seriozisht ambientin apo dëmton seriozisht shëndetin publik, ai mund të refuzojë dhënien e miratimit të tipit KE. Në këtë rast, ai u dërgon menjëherë shteteve të tjera anëtare dhe Komisionit një dosje të hollësishme duke shpjeguar arsyet për vendimin e tij dhe duke përcaktuar provat për konstatimet e tij.

4. Certifikatat e miratimit të tipit KE numërtohen në pajtim me metodën e përcaktuar në shtojcën VII.

5. Autoriteti miratues, brenda 20 ditëve pune, u dërgon autoriteteve miratuese të shteteve të tjera anëtare një kopje të certifikatës së miratimit të tipit KE për mjetin, së bashku me shtojcat, për secilin tip të mjeteve që ai ka aprovuar. Kopja në letër mund të zëvendësohet me kopje elektronike.

6. Autoriteti miratues informon pa vonesë autoritetet miratuese të shteteve të tjera anëtare për refuzimin apo tërheqjen e çdo miratim mjeti, së bashku me shkaqet për vendimin e tij.

7. Autoriteti miratues, në intervale tremujore, u dërgon autoriteteve miratuese të shteteve të tjera anëtare një listë të miratimeve të tipit KE të sistemit, pjesës përbërëse ose njësisë teknike të veçantë që ai ka dhënë, ndryshuar, refuzuar të japë apo tërhequr gjatë periudhës pararendëse. Kjo listë përmban hollësitë e specifikuar në shtojcën XIV.

8. Nëse kjo kërkohet nga një shtet tjetër anëtar, shteti anëtar që ka dhënë miratimin e tipit KE, brenda 20 ditëve pune nga marrja e asaj kërkesë, i dërgon një kopje të certifikatës së miratimit të tipit KE në fjalë, së bashku me shtojcat. Kopja në letër mund të zëvendësohet me kopje elektronike.

Neni 9

Dispozita të posaçme në lidhje me mjetet

1. DPSHTRR-ja, në harmoni të plotë me direktivën 2007/46/KE, jep një miratim KE në lidhje me:

a) një tip mjeti që përmbush hollësitë në skedarin e informacionit dhe që përmbush kërkesat teknike të parashikuara në aktet përkatëse rregullatore të renditura në shtojcën IV;

b) një tip mjeti për qëllim të veçantë që përmbush hollësitë në skedarin e informacionit dhe që përmbush kërkesat teknike të parashikuara në aktet përkatëse rregullatore të renditura në shtojcën XI.

Zbatohen procedurat e parashikuara në shtojcën V.

2. DPSHTRR-ja, në harmoni të plotë me direktivën 2007/46/KE, jep një miratim të tipit me disa faza në lidhje me një tip mjeti të pakompletuar ose të kompletuar që përmbush hollësitë në skedarin e informacionit dhe që përmbush kërkesat teknike të parashikuara në aktet përkatëse rregullatore të renditura në shtojcën IV ose shtojcën XI, duke pasur parasysh gjendjen e kompletimit të mjetit.

Miratimi i tipit me shumë faza zbatohet edhe për mjetet e përfunduara, të konvertuara ose të modifikuara nga një prodhues tjetër.

Zbatohen procedurat e parashikuara në shtojcën XVII.

3. Në lidhje me çdo tip mjeti, autoriteti miratues:

a) mbush seksionet përkatëse të certifikatës së miratimit të tipit KE, duke përfshirë fletën e rezultateve të testit bashkëngjitur, në pajtim me modelin e parashikuar në shtojcën VIII;

b) përpilon ose verifikon indeksin në paketën e informacionit;

c) i lëshon kërkuarit certifikatën e mbushur, së bashku me shtojcat e saj, pa vonesë të pajustificuar.

4. Në rastin e miratimit të tipit KE në lidhje me të cilin, në pajtim me nenet 20 ose 22, ose shtojcën XI, janë vendosur kufizime në lidhje me vlefshmërinë ose është hequr dorë nga dispozita të caktuara të akteve rregullatore, këto kufizime apo heqje dorë i specifikon certifikata e miratimit të tipit KE.

5. Nëse hollësitë në skedarin e informacionit specifikojnë dispozitat për mjetet për qëllime të veçantat, siç tregohet në shtojcën XI, certifikata e miratimit të tipit KE specifikon ato dispozita.

6. Nëse prodhuesi zgjedh procedurën e miratimit të përzier të tipit, autoriteti miratues, në pjesën III të dokumentit të informacionit, mbush modelin për të cilin përcaktohet në shtojcën III, referencat për raportet e testit, të vendosura nga aktet rregullatore, për të cilat nuk ofrohet certifikatë miratimi e tipit KE.

7. Nëse prodhuesi zgjedh procedurën e miratimit me një hap, autoriteti miratues vendos listën e akteve rregullatore të zbatueshme, formulari i së cilës tregohet në nënshtojcën e shtojcës VI, dhe ia bashkëngjijt atë listë certifikatës së miratimit të tipit KE.

Neni 10

Dispozita të posaçme në lidhje me sistemet, pjesët përbërëse ose njësitë teknike të veçanta

1. DPSHTRR-ja, në harmoni të plotë me direktivën 2007/46/KE, jep një miratim të tipit KE në lidhje me një sistem që përmbush hollësitë në skedarin e informacionit dhe që përmbush kërkesat teknike, të parashikuara në direktivën ose rregulloren përkatëse të veçantë, sipas parashikimit në shtojcën IV ose shtojcën XI.

2. DPSHTRR-ja, në harmoni të plotë me direktivën 2007/46/KE, jep miratim të tipit KE pjese përbërëse ose njësie teknike të veçantë në lidhje me një pjesë përbërëse ose njësi teknike të veçantë që përmbush hollësitë në skedarin e informacionit dhe që përmbush kërkesat teknike të parashikuara në direktivën ose rregulloren përkatëse të veçantë, sipas parashikimit në shtojcën IV.

3. Nëse pjesët përbërëse ose njësitë teknike të veçanta, të destinuara ose jo për riparim, shërbim ose mirëmbajtje, mbulohen, gjithashtu, nga një miratim tipi sistemi në lidhje me një mjet, nuk kërkohet asnjë miratim shtesë pjese përbërëse apo njësie të veçantë teknike, përveç kur parashikohet sipas aktit përkatës rregullator.

4. Nëse një pjesë përbërëse ose njësi teknike e veçantë e përmbush funksionin apo ofron një tipar specifik vetëm në bashkëveprim me pjesë të tjera të mjetit, duke bërë të mundur verifikimin e respektimit të kërkesave vetëm kur pjesa përbërëse apo njësia teknike e veçantë operon së bashku me ato pjesë të tjera të mjetit, objekti i miratimit të tipit KE të pjesës përbërëse apo njësisë teknike të veçantë kufizohet përkatësisht. Në këto raste, certifikata e miratimit të tipit KE specifikon çdo kufizim për përdorimin e saj dhe tregon kushtet e veçanta të montimit. Nëse kjo pjesë përbërëse apo njësi e veçantë teknike instalohet nga prodhuesi i mjetit, respektimi i kufizimeve të zbatueshme për përdorimin ose kushtet për montimin verifikohen në momentin kur aprovohet mjeti.

Neni 11

Testet e kërkuara për miratimin e tipit KE

1. Respektimi i përcaktimeve teknike të parashikuara në këtë udhëzim, në harmoni të plotë me direktivën 2007/46/KE, dhe në aktet rregullatore të renditura në shtojcën IV, demonstrohen nëpërmjet testeve të përshtatshme që kryhen nga shërbimet e caktuara teknike.

Procedurat e testit, pajisjet dhe veglat teknike të nevojshme për kryerjen e këtyre testeve përcaktohen në secilin prej këtyre akteve rregullatore.

2. Testet e kërkuara kryhen në mjetet, pjesët përbërëse dhe njësitë teknike të veçanta që janë përfaqësuese të tipit që aprovohet.

Megjithatë, prodhuesi, në marrëveshje me autoritetin miratues, mund të zgjedhë një mjet, sistem, pjesë përbërëse apo njësi teknike të veçantë që, megjithëse nuk është përfaqësuese e tipit që miratohet, kombinon një numër tiparesh më të pafavorshme në lidhje me nivelin e kërkuar të funksionimit. Metodot e testimit virtual mund të përdoren për të ndihmuar vendimmarrjen gjatë procesit të përzgjedhjes.

3. Si alternativa për procedurat e testeve të përmendura në paragrafin 1 dhe në marrëveshje me autoritetin e miratimit, metodat e testimit virtual mund të përdoren me kërkesë të prodhuesit në lidhje me aktet rregullatore të renditura në shtojcën XVI.

4. Kushtet e përgjithshme që duhet të përmbushen nga metodat e testimit virtual janë përcaktuar në shtojcën 1 të shtojcës XVI.

Për secilin prej akteve rregullatore të renditura në shtojcën XVI, kushtet specifike të testimit dhe dispozitat administrative në lidhje me to janë përcaktuar në shtojcën 2 të asaj shtojce.

5. Ministria e Punëve Publike dhe Transportit vendos listën e akteve rregullatore për të cilat lejohen metodat e testimit virtual, kushtet specifike dhe dispozitat administrative në lidhje me to. Këto masa, të planifikuara për të ndryshuar elementet jothelbësore të këtij udhëzimi, në harmoni të plotë me direktivën 2007/46/KE, ndër të tjera duke e plotësuar atë, vendosen dhe përditësohen në pajtim me procedurën rregullatore me verifikimin e përmendur në nenin 40(2).

Neni 12

Masat e përputhshmërisë së prodhimit

1. DPSHTRR-ja, në harmoni të plotë me direktivën 2007/46/KE, që jep miratime të tipit KE merr masat e nevojshme në pajtim me shtojcën X për të verifikuar, nëse është e nevojshme në bashkëpunim me autoritetet miratuese të shteteve të tjera anëtare, që të bëhen organizimet e duhura për të siguruar që prodhimi i mjeteve, sistemeve, pjesëve përbërëse ose njësisive teknike të veçanta, sipas rastit, përputhen me tipin e aprovuar.

2. DPSHTRR-ja, në harmoni të plotë me direktivën 2007/46/KE, që ka dhënë një miratim të tipit KE merr masat e nevojshme në pajtim me shtojcën X në lidhje me atë miratim për të verifikuar, nëse është e nevojshme në bashkëpunim me autoritetet miratuese të shteteve të tjera anëtare, që organizimet e përmendura në paragrafin 1 të vazhdojnë të jenë të përshtatshme dhe që prodhimi i mjeteve, sistemeve, pjesëve përbërëse ose njësive teknike të veçanta, sipas rastit, vazhdojnë të përputhen me tipin e miratuar.

Verifikimi për të siguruar që produktet përputhen me tipin e miratuar, është i kufizuar në procedurat e përcaktuara në shtojcën X dhe në ato akte rregullatore që përmbajnë kërkesa të veçanta. Për këtë qëllim, autoriteti miratues i shtetit anëtar që ka dhënë miratimin e tipit KE mund të kryejë çdo kontroll ose test të përcaktuar në një prej akteve rregullatore të renditura në shtojcën IV ose shtojcën XI në ekzemplarët e marrë në ambientet e prodhuesit, duke përfshirë mjetet e prodhimit.

3. Nëse DPSHTRR-ja, në harmoni të plotë me direktivën 2007/46/KE, që ka dhënë një miratim të tipit KE konstaton që organizimet e përmendura në paragrafin 1 nuk zbatohen, shmangen së tepërmi nga planet e organizimit dhe kontrollit të miratuara, apo kanë pushuar së zbatuari, megjithëse prodhimi nuk është ndërprerë, DPSHTRR-ja merr masat e nevojshme, duke përfshirë tërheqjen e miratimit të tipit, për të siguruar që përputhshmëria e procedurës së prodhimit ndiqet saktësisht.

KAPITULLI V NDRYSHIMET E MIRATIMEVE TË TIPIT KE

Neni 13

Dispozita të përgjithshme

1. Prodhuesi njofton pa vonesë autoritetin miratues që ka dhënë miratimin e tipit KE për çdo ndryshim në hollësitë e regjistruara në paketën e informacionit. Autoriteti miratues, në pajtim me rregullat e parashikuara në këtë kapitull, vendos se cila procedurë duhet të ndiqet. Nëse është e nevojshme, autoriteti miratues mund të vendosë, në konsultim me prodhuesin, që duhet të jepet një miratim i ri i tipit KE.

2. Një kërkesë për një ndryshim të një miratimi të tipit KE i paraqitet ekskluzivisht autoritetit miratues që ka dhënë miratimin fillestar të tipit KE.

3. Nëse autoriteti miratues konstaton që, për qëllimet e bërjes së një ndryshimi, janë të nevojshme inspektime të reja ose teste të reja, ai informon përkatësisht prodhuesin. Procedurat e përmendura në nenet 14 dhe 15 zbatohen vetëm pasi të jenë kryer me sukses inspektimet e reja ose testet e reja të nevojshme.

Neni 14

Dispozita të posaçme në lidhje me mjetet

1. Nëse kanë ndryshuar hollësitë e regjistruara në paketën e informacionit, ndryshimi përcaktohet si “rishikim”.

Në këto raste, autoriteti miratues lëshon faqen e rishikuar të paketës së informacionit sipas rastit, duke shënuar çdo faqe të rishikuar për të treguar qartë natyrën e ndryshimit dhe datën e rilëshimit. Një version i konsoliduar, i përditësuar i paketës së informacionit, i shoqëruar nga një përshkrim i hollësishëm i ndryshimeve, konsiderohet që përmbush këtë kërkesë.

2. Rishikimi përcaktohet “zgjerim” nëse, përveç kërkesave të paragrafit 1:

- a) kërkohen inspektime të tjera ose teste të reja;
- b) ka ndryshuar një informacion i certifikatës së miratimit të tipit KE, me përjashtim të shtojcave të saj;
- c) hyjnë në fuqi kërkesa të reja sipas çdo akti rregullator që zbatohen për tipin e mjetit të aprovuar.

Në këto raste, autoriteti miratues lëshon një certifikatë të rishikuar miratimi të tipit KE të shënuar me një numër zgjerimi, të shtuar në pajtim me numrin e zgjerimeve pasuese të dhëna.

Certifikata e miratimit tregon qartë arsyen e zgjerimit dhe datën e rilëshimit.

3. Sa herë që lëshohen faqet e ndryshuara ose një version i konsoliduar dhe i përditësuar, indeksi për paketën e informacionit bashkëngjitur certifikatës së miratimit ndryshohet përkatësisht për të treguar datën e zgjerimit ose rishikimit më të fundit, ose datën e përditësimit më të fundit të versionit.

4. Asnjë ndryshim për miratimin e një tipi mjeti nuk kërkohet nëse kërkesat e reja të përmendura në paragrafin 2(c), nga pikëpamja teknike, nuk i përkasin tipit të mjetit ose kanë të bëjnë me kategori mjetesh të ndryshme nga kategoria së cilës ai i përket.

Neni 15

Dispozita të posaçme në lidhje me sistemet, pjesët përbërëse ose njësitë teknike të veçanta

1. Nëse kanë ndryshuar hollësitë e regjistruara në paketën e informacionit, ndryshimi përcaktohet si “rishikim”.

Në këto raste, autoriteti miratues lëshon faqen e rishikuar të paketës së informacionit sipas rastit, duke shënuar çdo faqe të rishikuar për të treguar qartë natyrën e ndryshimit dhe datën e rilëshimit. Një version i konsoliduar, i përditësuar i paketës së informacionit, i shoqëruar nga një përshkrim i hollësishëm i ndryshimeve, konsiderohet se përmbush këtë kërkesë.

2. Rishikimi përcaktohet “zgjerim” nëse, përveç dispozitave të paragrafit 1:

- a) kërkohen inspektime të tjera ose teste të reja;
- b) ka ndryshuar një informacion i certifikatës së miratimit të tipit KE, me përjashtim të shtojcave të saj;
- c) hyjnë në fuqi kërkesa të reja sipas çdo akti rregullator që zbatohen për tipin e mjetit të aprovuar.

Në këto raste, autoriteti miratues lëshon një certifikatë të rishikuar miratimi të tipit KE të shënuar me një numër zgjerimi, të shtuar në pajtim me numrin e zgjerimeve pasuese të dhëna. Në rastet kur ndryshimi bëhet i domosdoshëm nga zbatimi i paragrafit 2(c), përditësohet seksioni i tretë i numrit të miratimit.

Certifikata e miratimit tregon qartë arsyen e zgjerimit dhe datën e rilëshimit.

3. Sa herë që lëshohen faqet e ndryshuara ose një version i konsoliduar dhe i përditësuar, indeksi për paketën e informacionit bashkëngjitur certifikatës së miratimit ndryshohet përkatësisht për të treguar datën e zgjerimit ose rishikimit më të fundit, ose datën e azhurnimit më të fundit të versionit të përditësuar.

Neni 16

Lëshimi dhe njoftimi i ndryshimeve

1. Në rastin e një zgjerimi, autoriteti miratues përditëson të gjitha seksionet e certifikatës së miratimit të tipit KE, shtojcat e saj dhe indeksin e paketës së informacionit. Certifikata e përditësuar dhe shtojcat e saj i lëshohen kërkuesit pa vonesë të pajustificuar.

2. Në rastin e një rishikimi, dokumentet e rishikuara ose versioni i konsoliduar, ose i përditësuar, sipas rastit, duke përfshirë indeksin e rishikuar të paketës së informacionit, i lëshohet kërkuesit nga autoriteti miratues pa vonesë të pajustificuar.

3. Autoriteti miratues u njofton autoriteteve miratuese të shteteve të tjera anëtare çdo ndryshim të bërë miratimeve të tipit KE në pajtim me procedurat e përmendura në nenin 8.

KAPITULLI VI

VLEFSHMËRIA E NJË MIRATIMI TË TIPIT KE PËR MJETET

Neni 17

Mbarimi i vlefshmërisë

1. Një miratim i tipit KE i një mjeti pushon së qeni i vlefshëm në një nga rastet e mëposhtme:

- a) bëhen të detyrueshme për regjistrim, shitje ose vënien në shërbim të mjeteve të reja kërkesa të reja në një akt rregullator të zbatueshëm për mjetin e miratuar dhe nuk është e mundur të përditësohet miratimi në mënyrë të përshtatshme;

- b) prodhimi i mjetit të miratuar ndërpritet përfundimisht me vullnet;
- c) vlefshmëria e miratimit skadon në bazë të një kufizimi të veçantë.

2. Nëse bëhet i pavlefshëm vetëm një variant brenda një tipi ose një version brenda një varianti, miratimi i tipit KE për mjetin në fjalë e humb vlefshmërinë vetëm në masën kur bëhet fjalë për variantin ose versionin e caktuar.

3. Nëse ndërpritet përfundimisht prodhimi i një tipi mjeti të caktuar, prodhimi njofton autoritetin miratues që ka dhënë miratimin e tipit KE për atë mjet.

Me marrjen e një njoftimi të tillë, ai autoritet informon autoritetet miratuese të shteteve të tjera anëtare përkatësisht brenda 20 ditëve pune. Neni 27 zbatohet vetëm për ndërprerjen në rrethanat e përmendura në paragrafin 1(a) të këtij neni.

4. Pa cenuar paragrafin 3, në rastet kur miratimi i tipit KE i një mjeti do të bëhet i pavlefshëm, prodhuesi njofton menjëherë autoritetin miratues që ka dhënë miratimin e tipit KE.

Autoriteti miratues, pa vonesë të pajustificuar, u komunikon të gjithë informacionin përkatës autoriteteve miratuese të shteteve të tjera anëtare për të mundësuar, sipas rastit, zbatimin e nenit 27. Ky komunikim specifikon, veçanërisht, datën e prodhimit dhe numrin e identifikimit të mjetit të fundit të prodhuar.

KAPITULLI VII CERTIFIKATA E PËRPUTHSHMËRISË DHE SHËNIMET

Neni 18

Certifikata e përputhshmërisë

1. Prodhuesi, në kapacitetin e tij si mbajtës i miratimit të tipit KE për një mjet, lëshon një certifikatë përputhshmërie për të shoqëruar çdo mjet, qoftë i përfunduar, i pakompletuar ose i kompletuar, që është prodhuar në pajtim me tipin e mjetit të miratuar.

Në rastin e një mjeti të pakompletuar ose të kompletuar, prodhuesi kompletton vetëm ata artikuj në faqen 2 të certifikatës së përputhshmërisë, që janë shtuar ose ndryshuar në fazën e tashme të miratimit dhe, sipas rastit, i bashkëngjit certifikatës të gjitha certifikatat e përputhshmërisë të lëshuara në fazën e mëparshme.

2. Certifikata e përputhshmërisë përpilohet në një prej gjuhëve zyrtare të Komunitetit. DPSHTRR-ja mund të kërkojë që certifikata e përputhshmërisë të jetë edhe në gjuhën shqipe.

3. Certifikata e përputhshmërisë projektohet për të parandaluar falsifikimin. Për këtë qëllim, letra duhet të jetë e mbrojtur me grafikë me ngjyra ose me një shenjë në formën e shenjës së identifikimit të prodhuesit.

4. Certifikata e përputhshmërisë kompletohet në tërësinë e saj dhe nuk përmban kufizime në lidhje me përdorimin e mjeteve të ndryshme nga ato të parashikuara në aktin rregullator.

5. Certifikata e përputhshmërisë e parashikuar në pjesën I të shtojcës IX për mjetet e miratuara në pajtim me dispozitat e nenit 20(2) përmban në titullin e saj shprehjen “Për mjetet e plota/kompletuara, të miratuara si tip në pajtim me nenin 20 (miratim i përkohshëm)”.

6. Certifikata e përputhshmërisë, sipas parashikimit në pjesën I të shtojcës IX për mjetet e miratuara si tip në pajtim me nenin 22 përmbajnë në titullin e tyre shprehjen “Për mjetet e plota/kompletuara të miratuara si tip në seri të vogla”, dhe pranë saj vitin e prodhimit e pasuar nga një numër rendor, ndërmjet 1 dhe kufirit të treguar në tabelën e përcaktuar në shtojcën XII, duke treguar, në lidhje me çdo vit prodhimi, pozicionin e atij mjeti brenda prodhimit të dhënë për atë vit.

7. Pa cenuar dispozitat e paragrafit 1, prodhuesi mund të transmetojë të dhënat ose informacionin që gjendet në certifikatën e përputhshmërisë me mjete elektronike në autoritetin e regjistrimit.

8. Një dublikatë e certifikatës së përputhshmërisë mund të lëshohet vetëm nga prodhuesi. Fjala “dublikatë” duhet të jetë qartësisht e dukshme në krye të çdo dublikate certifikate.

Neni 19

Shenja e miratimit të tipit KE

1. Prodhuesi i një pjese përbërëse ose një njësie teknike të veçantë, qoftë apo jo pjesë e një sistemi, i bashkëngjit shenjën e miratimit të tipit KE çdo pjese përbërëse ose njësisë së prodhuar në pajtim me tipin e miratuar, që kërkohet nga direktiva ose rregullorja përkatëse e veçantë.
2. Nëse nuk kërkohet një shenjë miratimi i tipit KE, prodhuesi i bashkëngjit të paktën emrin e tij tregtar ose markën tregtare dhe numrin e tipit dhe/ose një numër identifikimi.
3. Shenja e miratimit të tipit KE është në pajtim me shtojcën e shtojcës VII.

KAPITULLI VIII

TEKNOLOGJITË OSE KONCEPTET E REJA TË PAPAJTUESHME ME DIREKTIVAT E VEÇANTA

Neni 20

Përfundimet për teknologjitë e reja ose konceptet e reja

1. Shtetet anëtare me kërkesë të prodhuesit, mund të japë një miratim të tipit KE në lidhje me një tip sistemi, pjese përbërëse ose njësie e veçantë teknike që trupëzon teknologji ose koncepte që janë të papajtueshme me një ose më shumë akte rregullatore të renditura në pjesën I të shtojcës IV, duke iu nënshtruar autorizimit të dhënë nga Komisioni në pajtim me procedurën e përmendur në nenin 40(3).
2. Në pritje të vendimit nëse jepet autorizimi apo jo, shteti anëtar mund të japë një miratim provizor, të vlefshëm vetëm në territorin e vendit tonë, në lidhje me një tip mjeti që mbulohet nga përjashtimi i kërkuar, me kusht që të informojë për këtë Komisionin dhe shtetet e tjera anëtare pa vonesë nëpërmjet një dosjeje që përmban elementet e mëposhtme:
 - a) shkaqet që teknologjitë ose konceptet në fjalë e bëjnë sistemin, pjesën përbërëse ose njësinë teknike të veçantë të papajtueshme me kërkesat;
 - b) një përshkrim të vërejtjeve përkatëse mbi sigurinë dhe mjedisin dhe masat e marra;
 - c) një përshkrim të testeve, bashkë me rezultatet e tyre, të cilat tregojnë që, duke e krahasuar me kërkesat nga kërkohet përjashtimi, sigurohet të paktën një nivel i barabartë sigurie dhe mbrojtjeje mjedisi.
3. Shtetet e tjera anëtare mund të vendosin të pranojnë në territorin e tyre miratimin e përkohshëm të përmendur në paragrafin 2.
4. Komisioni, në pajtim me procedurën e përmendur në nenin 40(3), vendos nëse do të lejojë shtetin anëtar të japë një miratim të tipit KE në lidhje me atë tip mjeti.

Sipas rastit, vendimi përcakton, gjithashtu, nëse vlefshmëria e tij kufizohet me ndonjë kufizim, si afatet kohore. Në të gjitha rastet, vlefshmëria e miratimit nuk është më pak se 36 muaj.

Nëse Komisioni vendos të refuzojë autorizimin, shteti anëtar njofton menjëherë mbajtësin e miratimit të përkohshëm të tipit të përmendur në paragrafin 2 të këtij neni, që miratimi i përkohshëm do të revokohet gjashtë muaj pas datës së vendimit të Komisionit. Megjithatë, mjetet e prodhuara në pajtim me miratimin e përkohshëm para revokimit lejohen të regjistrohen, shiten ose të vihen në shërbim në çdo shtet anëtar që ka pranuar miratimin e përkohshëm.
5. Ky nen nuk zbatohet nëse një sistem, pjesë përbërëse ose njësi teknike e veçantë përputhet me një rregullore UNECE ku ka aderuar Komuniteti.

Neni 21

Veprimi i kërkuar

1. Nëse Komisioni konstaton që ka shkaqe të rëndësishme për dhënien e një përjashtimi në pajtim me nenin 20, ai merr menjëherë hapat e duhur për të përshtatur direktivat ose rregulloret e veçanta me zhvillimet teknologjike. Këto masa, të planifikuara për të ndryshuar elementet jothelbësore të direktivave ose rregulloreve të veçanta të renditura në pjesën I të shtojcës IV miratohen në pajtim me procedurën rregullatore me verifikimin e parashikuar në nenin 40(2).

Nëse përjashtimi në pajtim me nenin 20 ka të bëjë me një rregullore UNECE, Komisioni propozon një ndryshim për rregulloren UNECE në pajtim me procedurën e zbatueshme sipas Marrëveshjes së Rishikuar të vitit 1958.

2. Menjëherë sapo të jenë ndryshuar aktet rregullatore përkatëse, çdo kufizim në lidhje me përjashtimin hiqet menjëherë.

Nëse hapat e nevojshëm për përshtatjen e akteve rregullatore nuk ndërmerren, vlefshmëria e një përjashtimi mund të zgjatet, me kërkesë të shtetit anëtar që ka dhënë miratimin, me një vendim tjetër të miratuar në pajtim me procedurën e përmendur në nenin 40(3).

KAPITULLI IX MJETET E PRODHUARA NË SERI TË VOGLA

Neni 22

Miratimi i tipit KE në seri të vogla

1. Me kërkesë të prodhuesit dhe brenda kufijve sasiorë të përcaktuar në seksionin 1 të pjesës A të shtojcës XII, shtetet anëtare, në pajtim me procedurën e përmendur në nenin 6(4), japin një miratim të tipit KE në lidhje me një tip mjeti që përmbush të paktën kërkesat e renditura në shtojcën e pjesës I të shtojcës IV.

2. Paragrafi 1 nuk zbatohet për mjetet për qëllime të veçanta.

3. Certifikatat e miratimit të tipit KE numërtohen në pajtim me shtojcën VII.

Neni 23

Miratimi i tipit kombëtar në seri të vogla

1. Në rastin e mjeteve të prodhuara brenda kufijve sasiorë të përcaktuar në seksionin 2 të pjesës A të shtojcës XII, shtetet anëtare, mund të heqin dorë nga një ose më shumë dispozita të një ose më shumë të akteve rregullatore të renditura në shtojcën IV ose shtojcën XI, me kusht që ato të përcaktojnë kërkesat përkatëse relative.

“Kërkesat alternative” janë dispozita administrative dhe kërkesa teknike që synojnë sigurimin e një niveli të sigurisë rrugore dhe mbrojtjeje mjedisore që është i barasvlershëm me masën më të madhe të ushtruar në nivelin e parashikuar nga dispozitat e shtojcës IV ose XI, sipas rastit.

2. Shtetet anëtare, në rastin e mjeteve të përmendura në paragrafin 1, mund të heqë dorë nga një ose më shumë prej dispozitave të direktivës 2007/46/KE.

3. Nga dispozitat e përmendura në paragrafët 1 dhe 2 mund të hiqet dorë nëse shteti anëtar, ka shkaqe të arsyeshme për ta bërë këtë.

4. Për qëllimet e miratimit të tipit të mjeteve sipas këtij neni, shtetet anëtare, pranojnë sistemet, pjesët përbërëse ose njësitë teknike të veçanta, që janë të aprovuara si tip në pajtim me aktet rregullatore të renditura në shtojcën IV.

5. Certifikata e miratimit të tipit përcakton natyrën e heqjeve dorë të lejuara në pajtim me paragrafët 1 dhe 2.

Certifikata e miratimit të tipit, modeli i së cilës është i përcaktuar në shtojcën VI, nuk ka titullin “Certifikatë miratimi të tipit KE për mjetin”. Megjithatë, certifikatat e miratimit të tipit numërtohen në pajtim me shtojcën VII.

6. Vlefshmëria e miratimit të tipit kufizohet në territorin e shtetit anëtar që ka dhënë miratimin. Megjithatë, nëse prodhuesi e kërkon këtë, autoriteti miratues i dërgon një kopje të certifikatës së miratimit të tipit dhe shtojcave të saj me postë të regjistruar ose postë elektronike autoriteteve miratuese të shteteve anëtare të përcaktuara nga prodhuesi.

Brenda 60 ditëve nga marrja, ky shtet anëtar vendos nëse ai e pranon miratimin e tipit. Ai ia komunikon formalisht atë vendim autoritetit miratues të përmendur në nënparagrafin e parë.

Një shtet anëtar nuk refuzon miratimin e tipit, përveç kur ka shkaqe të arsyeshme për të besuar që dispozitat teknike në pajtim me të cilat është aprovuar mjeti nuk janë të barasvlershme me të vetat.

7. Me kërkesë të kërkuarit që dëshiron të shesë, të regjistrojë ose të vërë në shërbim një mjet në një shtet tjetër anëtar, shteti anëtar që ka dhënë miratimin i jep kërkuarit një kopje të certifikatës së miratimit të tipit duke përfshirë paketën e informacionit.

Një shtet anëtar lejon shitjen, regjistrimin ose vënien në shërbim të këtij mjeti përveç kur ka shkaqe të arsyeshme për të besuar që dispozitat teknike sipas të cilave është aprovuar mjeti nuk janë të barasvlershme me të vetat.

KAPITULLI X MIRATIMET INDIVIDUALE

Neni 24

Miratimet individuale

1. Shtetet anëtare mund të përjashtojnë një mjet të caktuar, qoftë unik apo jo, nga respektimi i një ose më shumë dispozitave të direktivës 2007/46/KE ose i një ose më shumë i akteve rregullore të renditura në shtojcën IV ose shtojcën XI, me kusht që ato të vendosin kërkesa alternative.

Nga dispozitat e përmendura në nënparagrafin 1 mund të hiqet dorë vetëm nëse një shtet anëtar ka shkaqe të arsyeshme për ta bërë këtë.

“Kërkesat alternative” janë dispozita administrative dhe kërkesa teknike që synojnë sigurimin e një niveli të sigurisë rrugore dhe mbrojtjeje mjedisore që është i barasvlershëm me masën më të madhe të ushtruar në nivelin e parashikuar nga dispozitat e shtojcës IV ose shtojcës XI, sipas rastit.

2. Shtetet anëtare nuk do të kryejnë teste destruktive. Ato përdorin çdo informacion përkatës të dhënë nga kërkuari që vërtetojnë përputhshmërinë me kërkesat alternative.

3. Shtetet anëtare pranojnë çdo miratim të tipit KE në lidhje me një sistem, pjesë përbërëse ose njësi të veçantë teknike në vend të kërkesave alternative.

4. Një kërkesë për miratim individual paraqitet nga prodhuesi ose nga pronari i një mjeti ose nga një person që vepron në emër të tyre, me kusht që ky i fundit të jetë themeluar në komunitet.

5. Një shtet anëtar jep një miratim individual nëse mjeti përputhet me përshkrimin e bashkëngjitur kërkesës dhe përmbush kërkesat e zbatueshme teknike dhe, pa vonesë të pajustificuar, lëshon certifikatën individuale të miratimit.

Formati i certifikatës së miratimit individual bazohet në modelin e certifikatës së miratimit të tipit KE të përcaktuar në shtojcën VI dhe përmban të paktën informacionin e nevojshëm për të mbushur kërkesën për regjistrim parashikuar nga direktiva e Këshillit 1999/37/KE e datës 29 prill 1999 për dokumentet e regjistrimit për mjetet. Certifikatat e miratimit individual nuk kanë titullin “Miratim mjeti KE”.

Një certifikatë miratimi individual mban numrin e identifikimit të mjetit përkatës.

6. Vlefshmëria e një aprovimi individual kufizohet në territorin e shtetit anëtar që ka dhënë miratimin.

Nëse një kërkuar dëshiron të shesë, të regjistrojë ose të vërë në shërbim në një shtet tjetër anëtar një mjet për të cilin është dhënë një miratim individual, shteti anëtar që ka dhënë miratimin, me kërkesë, i jep kërkuarit një deklaram të dispozitave teknike në bazë të të cilave është aprovuar mjeti.

Në lidhje me një mjet për të cilin është dhënë një miratim individual nga një shtet anëtar në pajtim me dispozitat e këtij neni, një shtet tjetër anëtar e lejon mjetin të shitet, regjistrohet ose të vihet në shërbim, përveç kur ka shkak të arsyeshëm për të besuar që dispozitat teknike në bazë të të cilave është aprovuar nuk janë të barasvlershme me të vetat.

7. Me kërkesë të prodhuesit ose të pronarit të mjetit, shtetet anëtare japin një miratim individual për një mjet që përmbush dispozitat e direktivës 2007/46/KE dhe aktet rregullore të renditura në shtojcën IV ose shtojcën XI, sipas rastit.

Në një rast të tillë, shtetet anëtare pranojnë miratimin individual dhe lejojnë shitjen, regjistrimin dhe vënien në shërbim të mjetit.

8. Dispozitat e këtij neni mund të zbatohen për mjetet që janë aprovuar si tip në pajtim me këtë udhëzim, në harmoni të plotë me direktivën 2007/46/KE, dhe që janë modifikuar para regjistrimit të tyre të parë ose hyrjes në shërbim.

Neni 25

Dispozita të posaçme

1. Procedura e parashikuar në nenin 24 mund të zbatohet për një mjet të veçantë gjatë fazave pasuese të kompletimit të tij në pajtim me një procedurë miratimi tipi me shumë faza.
2. Procedura e parashikuar në nenin 24 nuk mund të zëvendësojë një fazë të ndërmjetme brenda rrjedhës normale të një procedure miratimi tipi me shumë faza dhe nuk mund të zbatohet për qëllimet e marrjes së miratimit të fazës së parë të një mjete.

KAPITULLI XI

REGJISTRIMI, SHITJA DHE VËNIA NË SHËRBIM

Neni 26

Regjistrimi, shitja dhe vënia në shërbim e mjeteve

1. Pa cenuar dispozitat e neneve 29 dhe 30, shtetet anëtare regjistrojnë dhe lejojnë shitjen ose vënien e tyre në shërbim vetëm nëse ato shoqërohen me një certifikatë të vlefshme përputhshmërie të lëshuar në pajtim me nenin 18.

Në rastin e mjeteve të pakompletuara, shtetet anëtare lejojnë shitjen e këtyre mjeteve por mund të refuzojnë regjistrimin e tyre të përhershëm dhe vënien e tyre në shërbim për aq kohë sa mjete mbetet i pakompletuar.

2. Mjetet e përjashtuara nga kërkesa në lidhje me një certifikatë përputhshmërie mund të regjistrohen, shiten ose vihen në shërbim, vetëm nëse ato përmbushin kërkesat teknike përkatëse të këtij udhëzimi, në harmoni të plotë me direktivën 2007/46/KE.

3. Në lidhje me mjetet në seri të vogël, numri i mjeteve të regjistruara, të shitura ose të vëna në shërbim gjatë një viti të vetëm nuk kalon numrin e njësisive të treguara në pjesën A të shtojcës XII.

Neni 27

Regjistrimi, shitja dhe vënia në shërbim e mjeteve fund serie

1. Në pajtim me kufijtë e përcaktuar në seksionin B të shtojcës XII dhe në lidhje me vetëm një periudhë të kufizuar kohe, shtetet anëtare mund të regjistrojnë dhe lejojnë shitjen ose vënien në shërbim të mjeteve që përputhen me një tip mjete, miratimi i tipit KE të të cilit nuk vazhdon të mbetet i vlefshëm.

Nënparagrafi i parë zbatohet vetëm për mjetet brenda territorit të Komunitetit që janë mbuluar nga një miratim të tipit KE i vlefshëm në momentin e prodhimit të tyre, por që nuk janë regjistruar ose vënë në shërbim para se miratimi i tipit KE të ketë humbur vlefshmërinë.

2. Opsioni i parashikuar në paragrafin 1 ofrohet, në rastin e mjeteve të përfunduara, për një periudhë prej dymbëdhjetë muajsh nga data në të cilën skadon vlefshmëria e miratimit të tipit KE dhe, në rastin e mjeteve të kompletuara, për një periudhë prej tetëmbëdhjetë muajsh nga ajo datë.

3. Një prodhues që dëshiron të përfitojë nga dispozitat e paragrafit 1, i paraqet një kërkesë autoritetit kompetent të çdo shteti anëtar të prekur nga hyrja në shërbim e mjeteve në fjalë. Kërkesa duhet të specifikojë çdo shkak teknik ose ekonomik që pengon ato mjete në respektimin e kërkesave të reja teknike.

Shtetet anëtare të interesuara, brenda tre muajve nga marrja e një kërkesë të tillë, vendosin nëse dhe në cilën shifër të lejohet regjistrimi i atyre mjeteve brenda territorit të tyre.

4. Paragrafët 1, 2 dhe 3 zbatohen me ndryshimet e bëra për mjetet që mbulohen nga një miratim tipi kombëtar por që nuk janë regjistruar ose vënë në shërbim para se ai miratim të ketë pushuar së qeni i vlefshëm, në pajtim me nenin 45, për shkak të ekzekutimit të detyrueshëm të procedurës së miratimit të tipit KE.

5. Shtetet anëtare zbatojnë masa të përshtatshme për të siguruar që numri i mjeteve për t'u regjistruar ose vënë në shërbim në kuadrin e procedurës së parashikuar në këtë nen të mbikëqyren me efektivitet.

Neni 28

Shitja dhe vënia në shërbim e pjesëve përbërëse dhe njësive teknike të veçanta

1. Shtetet anëtare lejojnë shitjen ose vënien në shërbim të pjesëve përbërëse ose njësive teknike të veçanta nëse dhe vetëm nëse ato respektojnë kërkesat e akteve rregullatore përkatëse dhe shënohen rregullisht në pajtim me nenin 19.

2. Paragrafi 1 nuk zbatohet në rastin e pjesëve përbërëse ose njësive teknike të veçanta që janë ndërtuar ose projektuar enkas për mjetet e reja që nuk mbulohen nga ky udhëzim.

3. Me anë të shmangies nga paragrafi 1, shtetet anëtare lejojnë shitjen dhe vënien në shërbim të pjesëve përbërëse ose njësive teknike që janë përjashtuar nga një ose disa dispozita të një akti rregullator në zbatim të nenit 20 ose janë të destinuara për montim në mjetet e mbuluara nga provimet e dhëna sipas neneve 22, 23, ose 24 që kanë të bëjnë me pjesën përbërëse ose njësinë teknike të veçantë në fjalë.

4. Me anë të shmangies nga paragrafi 1 dhe përveç se kur parashikohet ndryshe në një akt rregullator, shtetet anëtare mund të lejojnë shitjen dhe vënien në shërbim të pjesëve përbërëse ose njësive teknike të veçanta që janë të destinuara për montim në mjetet që në momentin e vënies së tyre në shërbim nuk kërkoheshin nga direktiva 2007/46/KE ose nga direktiva 70/156/KEE të miratoheshin si tip KE.

KAPITULLI XII DISPOZITAT E GARANCIVE

Neni 29

Mjetet, sistemet, pjesët përbërëse ose njësitë teknike të veçanta në pajtim me direktivën 2007/46/KE

1. Nëse një shtet anëtar konstaton që mjetet, sistemet, pjesët përbërëse ose njësitë teknike të veçanta të reja, megjithëse janë në pajtim me kërkesat e zbatueshme ose të shënuara rregullisht, paraqesin rrezik për sigurinë në rrugë ose dëmtojnë seriozisht mjedisin ose shëndetin publik, ai shtet anëtar, për një periudhë maksimale prej gjashtë muajsh, mund të refuzojë të regjistrojë këtë mjet ose të lejojë shitjen apo vënien në shërbim në territorin e tij të këtyre mjeteve, pjesëve përbërëse ose njësive teknike të veçanta.

Në këto raste, shteti anëtar njofton menjëherë prodhuesin, shtetet e tjera anëtare dhe Komisionin përkatësisht, duke treguar shkaqet mbi të cilat bazohet vendimi i tij dhe, veçanërisht, nëse është rezultat i:

- mangësive në aktet përkatëse rregullatore; apo
- zbatim i pasaktë i kërkesave përkatëse.

2. Komisioni këshillohet me palët e interesuara sa më shpejt të jetë e mundur dhe, veçanërisht, me autoritetin miratues që ka dhënë miratimin e tipit, me qëllim që të përgatitë vendimin.

3. Nëse masat e përmendura në paragrafin 1 janë për shkak të mangësive në aktet përkatëse rregullatore, merren masat përkatëse, si më poshtë:

- nëse kanë të bëjnë me direktivat ose rregulloret e veçanta të renditura në pjesën I të shtojcës IV, Komisioni i ndryshon ato në pajtim me procedurën rregullatore sipas verifikimit të përmendur në nenin 40(2);

- nëse kanë të bëjnë me rregulloret UNECE, Komisioni propozon projektndryshimet e nevojshme për rregulloret UNECE përkatëse në pajtim me procedurën e zbatueshme sipas Marrëveshjes së Rishikuar 1958.

4. Nëse masat e përmendura në paragrafin 1 kanë të bëjnë me zbatimin e pasaktë të kërkesave përkatëse, Komisioni merr masat e nevojshme për të siguruar respektimin e këtyre kërkesave.

Neni 30

Mjetet, sistemet, pjesët përbërëse ose njësitë teknike të veçanta që nuk janë në pajtim me tipin e miratuar

1. Nëse një shtet anëtar që ka dhënë një miratim të tipit KE konstaton që mjete, sisteme, pjesë përbërëse ose njësi teknike të veçanta të reja që shoqërohen nga një certifikatë përputhshmërie ose që kanë shenjën e miratimit nuk përputhen me tipin që ai ka miratuar, ai merr të gjitha masat e nevojshme,

duke përfshirë, sipas rastit, tërheqjen e miratimit të tipit, për të siguruar që prodhimi i mjeteve, sistemeve, pjesëve përbërëse ose njësive teknike të veçanta, sipas rastit, të sillen në pajtim me tipin e miratuar. Autoriteti miratues i atij shteti anëtar vë në dijeni autoritetet miratuese të shteteve të tjera anëtare për masat e marra.

2. Për qëllimet e paragrafit 1, shmangiet nga hollësitë e certifikatës së miratimit të tipit KE ose nga paketa e informacionit konsiderohet se përbën mospërputhje me tipin e miratuar.

Një mjet nuk konsiderohet se shmanget nga tipi i miratuar nëse tolerancat lejohen nga aktet përkatëse rregullatore dhe ato toleranca respektohen.

3. Nëse një shtet anëtar vërteton që mjetet, pjesët përbërëse ose njësitë teknike të veçanta shoqërohen nga një certifikatë përputhshmërie ose që kanë një shenjë miratimi nuk përputhen me tipin e miratuar, ai mund t'i kërkojë shtetit anëtar që ka dhënë miratimin e tipit KE të verifikojë që mjetet, pjesët përbërëse ose njësitë teknike të veçanta në prodhim të vazhdojnë të përputhen me tipin e miratuar. Me marrjen e një kërkesë të tillë, shteti anëtar përkatës ndërmerr veprimet e nevojshme sa më shpejt të jetë e mundur dhe në çdo rast brenda gjashtë muajve nga data e kërkesës.

4. Autoriteti miratues i kërkon shtetit anëtar që ka dhënë miratimin e tipit për sistemin, pjesën përbërëse, njësinë teknike të veçantë apo mjetin e pakompletuar të ndërmarrë veprimet e duhura për të siguruar që mjetet në prodhim të sillen në pajtim me tipin e miratuar në rastet e mëposhtme:

a) në lidhje me një miratim të tipit mjetit KE, nëse mospërputhshmëria e një mjeti i vishet përjashtimisht mospërputhshmërisë së një sistemi, pjesë përbërëse ose njësie teknike të veçantë;

b) në lidhje me një miratim të tipit me disa faza, nëse mospërputhshmëria e një mjeti i vishet përjashtimisht mospërputhshmërisë së një sistemi, pjesë përbërëse apo njësie teknike të veçantë që është pjesë e mjetit të pakompletuar, ose vetë mjeti i pakompletuar.

Me marrjen e një kërkesë të tillë, shteti anëtar i interesuar ndërmerr veprimet e duhura, nëse është e nevojshme së bashku me shtetin anëtar që bën kërkesën, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në çdo rast brenda gjashtë muajve nga data e kërkesës. Nëse vihet re mospërputhshmëri, autoriteti miratues i shtetit anëtar që ka dhënë miratimin e tipit KE për sistemin, pjesën përbërëse ose njësinë teknike të veçantë ose miratimin e mjetit të pakompletuar merr masat e parashikuara në paragrafin 1.

5. Autoritetet e miratimit njoftojnë njëri-tjetrin brenda 20 ditëve pune për çdo tërheqje të miratimit të tipit KE dhe për shkaqet e saj.

6. Nëse shteti anëtar që ka dhënë miratimin e tipit KE kundërshton mospërputhjen e njoftuar, shteti anëtar i interesuar përpiqet të zgjidhë mosmarrëveshjen. Komisioni mbahet i informuar dhe, sipas rastit, zhvillon këshillimet e duhura me qëllim arritjen e një zgjidhjeje.

Neni 31

Shitja dhe vënia në shërbim e pjesëve ose pajisjeve që janë në gjendje të përbëjnë rrezik të ndjeshëm për funksionimin e saktë të sistemeve themelore

1. Shtetet anëtare lejojnë shitjen, ofertën për shitje ose vënien në shërbim të pjesëve ose pajisjeve që janë në gjendje të përbëjnë një rrezik të ndjeshëm për funksionimin e saktë të sistemeve që janë themelore për sigurinë e mjetit ose për ndikimin mjedisor, vetëm nëse ato pjesë apo pajisje janë autorizuar nga një autoritet miratues në pajtim me paragrafët 5 deri 10.

2. Pjesët apo pajisjet që i nënshtrohen autorizimit në pajtim me paragrafin 1 shtrihen në listën që vendoset në shtojcën XIII. Një vendim i tillë paraprihet nga një vlerësim që rezulton në një raport dhe përpykje për ekuilibër ndërmjet elementeve të mëposhtme:

a) ekzistencës së një rreziku serioz për sigurinë ose ndikimin mjedisor të mjeteve të pajisura me pjesët ose pajisjet nën shqyrtim; dhe

b) efektit pas shitjes mbi konsumatorët dhe prodhuesit të vendosjes në bazë të këtij neni të një kërkesë të mundshme për autorizim për pjesët ose pajisjet nën shqyrtim.

3. Paragrafi 1 nuk zbatohet për pjesët ose pajisjet origjinale që mbulohen nga një miratim tip sistemi në lidhje me një mjet dhe për pjesët ose pajisjet që janë të miratuara si tip në pajtim me dispozitat e një prej akteve rregullatore në shtojcën IV, përveç kur ato miratime kanë të bëjnë me aspekte të ndryshme nga ato që mbulohen nga paragrafi 1. Paragrafi 1 nuk zbatohet për pjesët dhe pajisjet që prodhohen përjashtimisht për mjetet e garës që nuk janë të destinuara për përdorim në rrugë publike. Nëse pjesët ose pajisjet e përfshira në shtojcën XIII kanë një përdorim të dyfishtë për gara dhe për në

rrugë, këto pjesë ose pajisje nuk mund të shiten apo ofrohen për shitje te publiku i gjerë për përdorim në mjetet rrugore, përveç kur ato përputhen me kërkesat e këtij neni.

Sipas rastit, Komisioni miraton dispozita për identifikimin e pjesëve ose pajisjeve të përmendura në këtë paragraf.

4. Komisioni, pas këshillimeve me palët e interesuara, vendos procedurën dhe kërkesat e procesit të autorizimit të përmendura në paragrafin 1, dhe miraton dispozitat për përditësimin pasues të listës së vendosur në shtojcën XIII. Këto kërkesa përfshijnë parashikime për sigurinë, mbrojtjen mjedisore dhe, sipas rastit, për standardet e testimi. Ato mund të bazohen në aktet rregullatore të renditura në shtojcën IV, mund të zhvillohen në pajtim me gjendjen përkatëse të sigurisë, teknologjinë mjedisore dhe të testimi, ose, nëse kjo është një mënyrë e përshtatshme për të arritur sigurinë e duhur apo objektivat mjedisore, mund të përbëhet nga një krahasim i pjesëve apo pajisjeve me ndikimin në mjedis apo në siguri të mjetit fillestar, ose të pjesëve të tij, sipas rastit.

5. Për qëllimet e paragrafit 1, prodhuesi i pjesëve ose pajisjeve i paraqet autoritetit miratues një raport testimi të hartuar nga një shërbim i caktuar teknik që certifikon që pjesët ose pajisjet për të cilat kërkohet autorizimi përputhen me kërkesat e përmendura në paragrafin 4. Prodhuesi mund të paraqesë vetëm një kërkesë për tip pjese te vetëm një autoritet miratues.

Kërkesa përfshin hollësi në lidhje me prodhuesin e pjesëve ose pajisjeve, tipin, identifikimin dhe numrin e pjesëve apo pajisjeve për të cilat kërkohet autorizimi, si dhe emrin e prodhuesit të mjetit, tipin e mjetit dhe, sipas rastit, vitet e prodhimit dhe çdo informacion tjetër që lejon identifikimin e mjetit për të cilin është destinuar instalimi i këtyre pjesëve apo pajisjeve.

Nëse autoriteti miratues bindet, duke marrë parasysh raportin e testit dhe prova të tjera, që pjesët ose pajisjet në fjalë përmbushin kërkesat e përmendura në paragrafin 4, ai i lëshon prodhuesit një certifikatë pa vonesë të pajustificuar. Kjo certifikatë autorizon që pjesët ose pajisjet të shiten, ofrohen për shitje ose të instalohen në mjete në Komunitet, në pajtim me nënparagrafin e dytë të paragrafit 9.

6. Çdo pjesë apo artikull pajisjeje i autorizuar në zbatim të këtij neni shënohet rregullisht.

Komisioni vendos kërkesat për shënimin dhe paketimin, si dhe modelin dhe sistemin e numërtimit të certifikatës së përmendur në paragrafin 5.

7. Masat e përmendura në paragrafët 2 deri 6 miratohen në pajtim me procedurën rregullatore me verifikimin e përmendur në nenin 40(2) pasi ato janë të destinuara për të ndryshuar elemente jothelbësore të këtij udhëzimi, në harmoni të plotë me direktivën 2007/46/KE, ndërmjet të tjerash, duke e plotësuar atë.

8. Prodhuesi njofton pa vonesë autoritetin miratues që ka lëshuar certifikatën për çdo ndryshim që cenon kushtet në bazë të të cilëve është dhënë. Autoriteti miratues vendos nëse certifikata duhet të rishikohet apo rilëshohet dhe nëse janë të nevojshme teste të reja.

Prodhuesi është përgjegjës për të siguruar që pjesët dhe pajisjet të prodhohen dhe të vazhdojnë të prodhohen sipas kushteve sipas të cilave është lëshuar certifikata.

9. Para lëshimit të një autorizimi, autoriteti miratues verifikon ekzistencën e masave dhe procedurave të pranueshme për të siguruar kontroll të efektshëm të përputhshmërisë së prodhimit.

Nëse autoriteti miratues konstaton që kushtet për lëshimin e autorizimit nuk vazhdojnë të përmbushen, ai i kërkon prodhuesit të marrë masat e nevojshme për të siguruar që pjesët ose pajisjet të bëhen të përputhshme. Nëse është e nevojshme, ai e tërheq autorizimin.

10. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet shteteve anëtare në lidhje me certifikatat e përmendura në paragrafin 5 sillen në vëmendje të Komisionit. Ai merr masat e përshtatshme, duke përfshirë, sipas rastit, kërkimin e tërheqjes së autorizimit, pas këshillimit me shtetet anëtare.

11. Ky nen nuk është i zbatueshëm për një pjesë apo artikull pajisjeje para se ai të renditet në shtojcën XIII. Për çdo të dhënë apo grupe të dhënash në shtojcën XIII, caktohet një periudhë e arsyeshme kalimtare për t'i mundësuar prodhuesit të pjesës ose pajisjes të kërkojë dhe marrë një autorizim. Në të njëjtën kohë mund të caktohet një datë, sipas rastit, për të përjashtuar nga zbatimi i këtij neni pjesët dhe pajisjet e projektuara për mjetet e miratuara si tip para asaj date.

12. Nëse nuk është marrë një vendim në një pjesë apo artikull pajisjeje duhet të përfshihet në listën e përmendur në paragrafin 1, shtetet anëtare mund të mbajnë dispozitat e brendshme që trajtojnë pjesët ose pajisjet që janë në gjendje të përbëjnë një rrezik të ndjeshëm për funksionimin e saktë të sistemeve që janë themelore për sigurinë e mjetit ose ndikimin e tij në mjedis.

Nëse në lidhje me këtë është marrë një vendim, dispozitat e brendshme që trajtojnë pjesët apo pajisjet në fjalë pushojnë së qeni të vlefshme.

13. Që nga 29 tetori 2007, shtetet anëtare nuk miratojnë dispozita të reja që trajtojnë pjesë dhe pajisje që mund të ndikojnë në funksionimin e saktë të sistemeve që janë themelore për sigurinë e mjetit ose ndikimin e tij në mjedis.

Neni 32

Tërheqja e mjeteve

1. Nëse një prodhues të cilit i është dhënë një miratim tipi mjeti KE është i detyruar, në zbatim të dispozitave të një akti rregullator ose të direktivës 2001/95/KE, të tërheqë mjetet e shitura, të regjistruara apo të vëna në shërbim për shkak të një ose më shumë sistemeve, pjesëve përbërëse apo njësisive teknike të veçanta të instaluara në mjet, të miratuara ose jo rregullisht në pajtim me këtë udhëzim, në harmoni të plotë me direktivën 2007/46/KE, paraqesin një rrezik serioz për sigurinë në rrugë, shëndetin publik ose mbrojtjen e mjedisit, ai informon menjëherë autoritetin miratues që ka dhënë miratimin e mjetit

2. Prodhuesi i propozon autoritetit miratues një tërësi masash të përshtatshme për të asgjësuar rrezikun e përmendur në paragrafin 1. Autoriteti miratues ua komunikon masat e propozuara autoriteteve të shteteve të tjera anëtare pa vonesë.

Autoritetet kompetente sigurojnë që masat të zbatohen me efektivitet në territoret e tyre përkatëse.

3. Nëse masat konsiderohen nga autoritetet përkatëse si të pamjaftueshme ose që nuk janë zbatuar me shpejtësinë e duhur, ata informojnë menjëherë autoritetin miratues që ka dhënë miratimin e tipit të mjetit KE.

Autoriteti miratues njofton pastaj prodhuesin. Nëse autoriteti miratues që ka dhënë miratimin e tipit KE nuk është i bindur për masat e prodhuesit, ai merr të gjitha masat mbrojtëse të duhura, duke përfshirë tërheqjen e miratimit të tipit të mjetit KE nëse prodhuesi nuk propozon dhe zbaton masat korrigjuese të efektshme. Në rastin e tërheqjes së miratimit të tipit të mjetit KE, autoriteti përkatës miratues njofton prodhuesin, autoritetet miratues të shteteve të tjera anëtare dhe Komisionin me letër të regjistruar ose mjete të barasvlershme elektronike brenda 20 ditëve pune.

4. Ky nen zbatohet gjithashtu për pjesët që nuk i nënshtrohen asnjë kërkesë sipas një akti rregullator.

Neni 33

Njoftimi i vendimeve dhe mjeteve të disponueshme

Të gjitha vendimet e marra në pajtim me këtë udhëzim, në harmoni të plotë me direktivën 2007/46/KE dhe të gjitha vendimet që refuzojnë ose tërheqin një miratim të tipit KE, ose refuzojnë regjistrimin ose ndalojnë shitjet, shprehin me hollësi arsyet mbi të cilat bazohen.

Çdo vendim i tillë i njoftohet palës përkatëse që, në të njëjtën kohë, njoftohet për mjetet e disponueshme për të sipas ligjeve në fuqi në shtetin anëtar përkatës dhe për afatet kohore të lejuara për ushtrimin e këtyre mjeteve.

KAPITULLI XIII

RREGULLORE NDËRKOMBËTARE

Neni 34

Rregulloret UNECE që kërkohen për miratimin e tipit KE

1. Rregulloret UNECE ku ka aderuar Komuniteti dhe që janë të renditura në pjesën II të shtojcën IV dhe në shtojcën XI janë pjesë e miratimit të tipit KE për një mjet në të njëjtën mënyrë si direktivat dhe rregulloret e veçanta. Ato zbatohen për kategoritë e mjeteve të renditura në shtyllat përkatëse në tabelën e pjesës I të shtojcës IV dhe shtojcën XI.

2. Nëse Komuniteti ka vendosur të zbatojë me bazë të detyrueshme një rregullore UNECE për qëllimin e miratimit të tipit të mjetit KE në pajtim me nenin 4(4) të vendimit 97/836/KE, shtojcat e direktivës 2007/46/KE, ndryshohen sipas rastit në pajtim me procedurën rregullatore me verifikimin e përmendur në nenin 40(2) të direktivës 2007/46/KE. Akti që ndryshon shtojcat e direktivës 2007/46/KE, përcakton gjithashtu datat e zbatimit të detyruar të rregullores UNECE dhe të ndryshimeve të saj. Shtetet anëtare shfuqizojnë ose përshtatin legjislacionin e tyre të brendshëm që nuk është në pajtim me rregulloren UNECE në fjalë.

Nëse një rregullore UNECE e tillë zëvendëson një direktivë apo rregullore të veçantë, hyrja përkatëse në pjesën II të shtojcës IV dhe në shtojcën XI zëvendësohet me numrin e rregullores UNECE dhe hyrja përkatëse në pjesën II të shtojcës IV fshihet në pajtim me të njëjtën procedurë.

3. Në rastet e përmendura në nënparagrafin e dytë të paragrafit 2, direktiva ose rregullorja e veçantë e zëvendësuar nga rregullorja UNECE shfuqizohet në pajtim me procedurën rregullatore me verifikimin e përmendur në nenin 40(2).

Nëse shfuqizohet një direktivë e veçantë, shtetet anëtare shfuqizojnë legjislacionin e tyre të brendshëm që është miratuar për transpozimin e asaj direktive.

4. Në direktivën 2007/46/KE ose në direktiva ose rregullore të veçanta mund të bëhen referenca të drejtpërdrejta në standardet dhe rregulloret ndërkombëtare pa i riprodhuar ato në kuadrin ligjor të Komunitetit.

Neni 35

Barasvlershmëria e rregulloreve UNECE me direktivat ose rregulloret

1. Rregulloret UNECE të renditura në pjesën II të shtojcave IV njihen si të barasvlershme me direktivat dhe rregulloret e veçanta përkatëse në masën që ato kanë të njëjtën fushë zbatimi dhe objekt.

Autoritetet miratuese të shteteve anëtare pranojnë miratimet e dhëna në pajtim me ato rregullore UNECE dhe, sipas rastit, shenjat përkatëse të miratimit, në mungesë të miratimeve përkatëse dhe shenjave të miratimit të dhëna në pajtim me direktivën ose rregulloren përkatëse të barasvlershme.

2. Nëse Komuniteti ka vendosur të zbatojë, për qëllimet e paragrafit 1, një rregullore të re UNECE ose një rregullore UNECE të ndryshuar, pjesa II e shtojcës IV do të ndryshohet përkatësisht. Këto masa, të planifikuara për të ndryshuar elementet jothelbësore të direktivës 2007/46/KE, miratohen në pajtim me procedurën rregullatore me verifikimin e përmendur në nenin 40(2).

Neni 36

Barasvlershmëria me rregullore të tjera

Këshilli, duke vepruar me shumicë të cilësuar me propozim të Komisionit, mund të njohë barasvlershmërinë ndërmjet kushteve ose dispozitave për miratimin e tipit KE të sistemeve, pjesëve përbërëse dhe njësive teknike të veçanta të vendosur me direktivën 2007/46/KE dhe procedurat e vendosura me rregulloret ndërkombëtare ose rregullore të vendeve të treta, në kuadrin e marrëveshjeve shumëpalëshe ose dypalëshe ndërmjet Komunitetit dhe vendeve të treta.

KAPITULLI XIV

DHËNIA E INFORMACIONIT TEKNIK

Neni 37

Informacioni i destinuar për përdoruesit

1. Prodhuesi nuk mund të japë asnjë informacion teknik në lidhje me hollësitë e parashikuara në direktivën 2007/46/KE, ose në aktet rregullatore të renditura në shtojcën IV që shmanget nga hollësitë e aprovuara nga autoriteti miratues.

2. Nëse një akt rregullator e parashikon këtë në mënyrë të posaçme, prodhuesi u jep përdoruesve të gjithë informacionin përkatës dhe udhëzimet e nevojshme duke përshkruar të gjitha kushtet dhe kufizimet e veçanta që kanë të bëjnë me përdorimin e një mjete, pjese përbërëse ose njësie teknike të veçantë.

Ky informacion jepet në gjuhët zyrtare të Komunitetit, mundësisht dhe në gjuhën shqipe. Ai jepet në marrëveshje me autoritetin miratues, në një dokument shoqërues të përshtatshëm, si manuali i pronarit ose libri i mirëmbajtjes.

Neni 38

Informacioni i destinuar për prodhuesit e pjesëve përbërëse ose njësive teknike të veçanta

1. Prodhuesi i mjetit i ofron prodhuesit të pjesëve përbërëse ose njësive teknike të veçanta të gjitha ato hollësi, duke përfshirë, sipas rastit, skicat e renditura në mënyrë të posaçme në shtojcën ose shtojcën e një akti rregullator që janë të nevojshme për një miratim të tipit KE të pjesëve përbërëse ose njësive teknike të veçanta, ose të nevojshme për të marrë një autorizim sipas nenit 31.

Prodhuesi i mjetit mund të imponojë një marrëveshje detyruese për prodhuesit e pjesëve përbërëse ose njësive teknike të veçanta për të mbrojtur konfidencialitetin e një informacioni që nuk është në sferën publike, duke përfshirë atë që ka të bëjë me të drejtat e pronësisë intelektuale.

2. Prodhuesi i pjesëve përbërëse ose njësive teknike të ndara, në cilësinë e tij si zotërues i një certifikate miratimi të tipit KE që, në pajtim me nenin 10(4), përfshin kufizimet për përdorimin ose kushtet e veçanta të montimit apo të dyja, i jep për këtë të gjithë informacionin prodhuesit të mjetit.

Nëse një akt rregullator e parashikon një gjë të tillë, prodhuesi i pjesëve përbërëse ose njësive teknike të veçanta, së bashku me pjesët përbërëse ose njësitë teknike të veçanta, jep edhe udhëzimet në lidhje me kufizimet për përdorimin ose kushtet e veçanta të montimit apo të dyja.

KAPITULLI XV

MASAT ZBATUESE DHE NDRYSHIMET

Neni 39

Masat zbatuese dhe ndryshimet e direktivës 2007/46/KE dhe direktivat dhe rregulloret e veçanta

1. Komisioni miraton masat e nevojshme për zbatimin e çdo direktive ose rregulloreje të veçantë në pajtim me rregullat e parashikuara në secilën direktivë ose rregullore përkatëse.

2. Komisioni miraton ndryshimet e shtojcave të direktivës 2007/46/KE ose të dispozitave të direktivave ose rregulloreve të veçanta të renditura në pjesën I të shtojcës IV, që janë të nevojshme për t'i përshtatur ato në zhvillimin e njohurive shkencore dhe teknike ose për nevojat specifike të personave me aftësi të kufizuara.

3. Komisioni miraton ndryshimet e direktivës 2007/46/KE që janë të nevojshme për të vendosur kërkesat teknike për mjetet me seri të vogël, mjetet e miratuara sipas procedurës së miratimit individual dhe mjetet për qëllime të veçanta.

4. Nëse Komisioni vjen në dijeni të rreziqeve serioze për përdoruesit e rrugës ose për mjedisin, që kërkon masa urgjente, ai mund të ndryshojë dispozitat e direktivave ose rregulloreve të veçanta të renditura në pjesën I të shtojcës IV.

5. Komisioni miraton ndryshimet që janë të nevojshme në interes të administrimit të mirë dhe veçanërisht ato që nevojiten për të siguruar njëtrajtshmëri të direktivave dhe rregulloreve të veçanta të renditura në pjesën I të shtojcës IV ndërmjet tyre ose me pjesë të tjera të së drejtës komunitare.

6. Nëse, në zbatim të vendimit 97/836/KE, janë miratuar rregulloret e reja UNECE ose ndryshimet e rregulloreve UNECE ekzistuese ku ka aderuar Komuniteti, Komisioni ndryshon përkatësisht shtojcat e direktivës 2007/46/KE.

7. Çdo direktivë ose rregullore e re e veçantë paraqet ndryshimet e përshtatshme për shtojcat e direktivës 2007/46/KE.

8. Shtojcat e direktivës 2007/46/KE mund të ndryshohen nëpërmjet rregulloreve.

9. Masat e përmendura në këtë nen miratohen në pajtim me procedurën rregullatore me verifikimin e përmendur në nenin 40(2) meqenëse ato janë planifikuar për të ndryshuar elementet jothelbësore të direktivës 2007/46/KE ose të direktivave apo rregulloreve të veçanta, ndërmjet të tjerash duke i plotësuar ato.

Neni 40

Komiteti

1. Komisioni asistohet nga një komitet i quajtur “Komitet teknik – mjete motorike” (TCMV).
 2. Nëse bëhet referencë në këtë paragraf, neni 5a(1) deri (4), dhe neni 7 i vendimit 1999/468/KE zbatohen duke pasur parasysh dispozitat e nenit 8 të tij.
 3. Nëse bëhet referencë në këtë paragraf, nenet 5 dhe 7 të vendimit 1999/468/EC zbatohen duke pasur parasysh dispozitat e nenit 8 të tij.
- Periodha e përmendur në nenin 5(6) të vendimit 1999/468/EC caktohet tre muaj.

KAPITULLI XVI

EMËRIMI DHE NJOFTIMI I SHËRBIMEVE TEKNIKE

Neni 41

Caktimi i shërbimeve teknike

1. Kur një shtet anëtar cakton një shërbim teknik, ky i fundit respekton dispozitat e direktivës 2007/46/KE.
2. Shërbimet teknike kryejnë vetë ose mbikëqyrin testet e kërkuara për miratimin ose inspektimet e përcaktuara në direktivën 2007/46/KE, ose në një akt rregullator të renditur në shtojcën IV, përveç kur procedurat alternative janë lejuar posaçërisht. Ata nuk mund të zhvillojnë teste apo inspektime për të cilat ata nuk janë caktuar sipas rregullit.
3. Shërbimet teknike përfshihen në një ose më shumë prej katër kategorive të mëposhtme, në varësi të fushës së tyre të kompetencës:
 - a) kategoria A, shërbime teknike që kryejnë testet e përmendura në direktivën 2007/46/KE, dhe në aktet rregullatore të renditura në shtojcën IV në ambientet e tyre;
 - b) kategoria B, shërbime teknike që mbikëqyrin testet e përmendura në direktivën 2007/46/KE, dhe në aktet rregullator të renditura në shtojcën IV, të kryera në ambientet e prodhuesit ose në ambientet e një pale të tretë;
 - c) kategoria C, shërbime teknike që vlerësojnë dhe mbikëqyrin me bazë të rregullt procedurat e prodhuesit për kontrollimin e përputhshmërisë së prodhimit;
 - d) kategoria D, shërbimet teknike që mbikëqyrin ose kryejnë teste ose inspektime në kuadrin e mbikëqyrjes së përputhshmërisë së prodhimit.
4. Shërbimet teknike demonstrojnë aftësi të përshtatshme, njohuri specifike teknike dhe eksperiencë të provuar në fushat specifike të mbuluara në direktivën 2007/46/KE, dhe aktet rregullatore të renditura në shtojcën IV.

Përveç kësaj, shërbimet teknike respektojnë standardet e renditura në shtojcën 1 të shtojcës V që janë të rëndësishme për aktivitetet që ata kryejnë. Megjithatë, kjo kërkesë nuk zbatohet për qëllimet e fazës së fundit të një procedure miratimi të tipit me shumë faza siç përmendet në nenin 25(1).
5. Një autoritet miratimi mund të veprojë si shërbim teknik për një ose më shumë aktivitete të përmendura në paragrafin 3.
6. Një prodhues ose një palë e nënkontraktuar që vepron në emër të tij mund të caktohet si shërbim teknik për aktivitetet e kategorisë A në lidhje me aktet rregullatore të renditura në shtojcën XV.

Komisioni ndryshon listën e këtyre akteve rregullatore, sipas rastit, në pajtim me procedurën rregullatore me verifikimin e përmendur në nenin 40(2).
7. Subjektet e përmendura në paragrafët 5 dhe 6 u përmbahen dispozitave të këtij neni.
8. Shërbimet teknike, të ndryshme nga ato të caktuara në pajtim me paragrafin 6, të një vendi të tretë mund të njoftohen për qëllimet e nenit 43 vetëm në kuadrin e një marrëveshjeje dypalëshe ndërmjet Komunitetit dhe vendit të tretë në fjalë.

Neni 42

Vlerësimi i aftësive të shërbimeve teknike

1. Aftësitë e përmendura në nenin 41 vërtetohen nga një raport vlerësimi i vendosur nga një autoritet kompetent. Kjo mund të përfshijë një certifikatë akreditimi të lëshuar nga një organ akreditimi.
- 3436

2. Vlerësimi në të cilin bazohet raporti i përmendur në paragrafin 1 zhvillohet në pajtim me dispozitat e shtojcës 2 të shtojcës V.

Raporti i vlerësimit rishikohet pas një periudhe maksimale prej tre vjetësh.

3. Raporti i vlerësimit i komunikohet Komisionit me kërkesë.

4. Autoriteti i miratimit që vepron si shërbim teknik vërteton përputhshmërinë nëpërmjet provave shkresore.

Kjo përfshin një vlerësim të zhvilluar nga auditët e pavarur nga aktiviteti që vlerësohet. Këta auditë mund të jenë nga e njëjta organizatë, me kusht që ata të drejtohen në mënyrë të pavarur nga personeli që ndërmerr aktivitetin e vlerësuar.

5. Një prodhues, ose një palë nënkontraktuese që vepron në emër të tij, i caktuar si shërbim teknik u përmbahet dispozitave përkatëse të këtij neni.

Neni 43

Procedurat e njoftimit

1. Shtetet anëtare njoftojnë Komisionin për emrin, adresën, duke përfshirë adresën elektronike, personat përgjegjës dhe kategorinë e aktiviteteve në lidhje me secilin shërbim teknik të caktuar. Ata e njoftojnë atë për çdo ndryshim të mëvonshëm.

Akti i njoftimit shpreh se në lidhje me cilat akte rregullatore janë caktuar shërbimet teknike.

2. Një shërbim teknik mund të zhvillojë aktivitetet e përshkruara në nenin 41 për qëllimet e miratimit të tipit vetëm nëse i është njoftuar paraprakisht Komisionit.

3. I njëjti shërbim teknik mund të caktohet dhe njoftohet nga disa shtete anëtare pavarësisht nga kategoria e aktiviteteve që ai zhvillon.

4. Nëse një organizatë specifike ose një organ kompetent, aktiviteti i të cilit nuk është përfshirë në ato të përmendur në nenin 41, duhet të caktohet në zbatim të një akti rregullator, njoftimi i bëhet në pajtim me dispozitat e këtij neni.

5. Komisioni shpall një listë dhe hollësitë në lidhje me autoritetet e miratimit dhe shërbimet teknike në faqen e internetit.

KAPITULLI XVII

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 44

Dispozita kalimtare

1. Në pritje të ndryshimeve të nevojshme të direktivës 2007/46/KE, me qëllim që të përfshihen mjetet që nuk janë të mbuluara ose për të përfunduar dispozitat teknike dhe administrative në lidhje me miratimin e tipit të mjeteve të ndryshme nga M1 të prodhuara në seri të vogla, dhe për të vendosur dispozita të harmonizuara administrative dhe teknike në lidhje me procedurën individuale të miratimit, dhe në pritje të skadimit të periudhave kalimtare të parashikuara në nenin 45, shtetet anëtare vazhdojnë të japin miratime të brendshme për ato mjete, me kusht që këto miratime të bazohen në kërkesat e harmonizuara teknike të parashikuara në direktivën 2007/46/KE.

2. Me kërkesë të prodhuesit ose, në rastin e miratimit individual, të pronarit të mjetit dhe me dhënien e informacionit të duhur, shteti anëtar përkatës mbush dhe lëshon certifikatën e miratimit të tipit ose certifikatën e miratimit individuale, sipas rastit. Certifikata i lëshohet kërkuarit.

Në lidhje me mjetet e të njëjtit tip, shtetet e tjera anëtare pranojnë një kopje të vërtetë të certifikuar si provë që kanë kryer testet e nevojshme.

3. Nëse një mjet i caktuar i mbuluar me një miratim individual duhet të regjistrohet në një shtet tjetër anëtar, ai shtet anëtar mund të kërkojë, nga autoriteti miratues që ka lëshuar miratimin individual, çdo informacion shtesë që tregon me hollësi natyrën e kërkesave teknike që përmbushen nga mjete i caktuar.

4. Në pritje të harmonizimit të sistemeve të regjistrimit dhe tatimeve të shteteve anëtare në lidhje me mjetet e mbuluara nga direktiva 2007/46/KE, shtetet anëtare mund të përdorin kodet kombëtare me qëllim që të lehtësohet regjistrimi dhe tatimi në territorin e tyre. Për këtë qëllim, shtetet anëtare mund të

ndajnë më tej versionet e treguara në pjesën II të shtojcës III, me kusht që hollësitë e përdorura për nënndarjen të jenë treguar shprehimisht në paketën e informacionit ose mund të përftohen prej saj me llogaritje të thjeshtë.

Neni 45

Datat e bërjes së kërkesës për miratimin e tipit KE

1. Në lidhje me miratimin e tipit KE, shtetet anëtare japin miratimin e tipit KE për tipat e rinj të mjetit nga datat e specifikuar në shtojcën XIX.

2. Me kërkesë të prodhuesit, shtetet anëtare mund të japin miratimin e tipit KE për tipat e rinj të mjeteve nga data 29 prill 2009.

3. Deri në datat e përcaktuara në kolonën e katërt të tabelës së përcaktuar në shtojcën XIX, neni 26(1) nuk zbatohet për mjetet e reja për të cilat është dhënë një miratim kombëtar para datave të specifikuara në kolonën e tretë të saj ose për të cilën nuk ka pasur miratim.

4. Me kërkesë të prodhuesit dhe deri në datat e përcaktuara në shtyllën 3 të radhëve 6 dhe 9 të tabelës së dhënë në shtojcën XIX, shtetet anëtare vazhdojnë të japin miratimet e tipit të brendshme si një alternativë për miratimin e tipit KE të mjeteve për mjetet e kategorisë M2 ose M3 me kusht që ato mjete dhe sistemet, pjesët përbërëse dhe njësitë teknike të veçanta të jenë miratuar si tip në pajtim me aktet rregullatore të renditura në pjesën I të shtojcës IV të direktivës 2007/46/KE.

5. Direktiva 2007/46/KE nuk zhvlerëson miratimet e tipit KE të dhëna për mjetet e kategorisë M1 para datës 29 prill 2009 dhe as pengon zgjerimin e këtyre miratimeve.

6. Në lidhje me miratimin të tipave të rinj KE të sistemeve, pjesëve përbërëse ose njërive të veçanta teknike, shtetet anëtare e zbatojnë direktivën 2007/46/KE nga data 29 prill 2009.

Direktiva 2007/46/KE nuk zhvlerëson asnjë miratim të tipit KE të dhënë për sistemet, pjesët përbërëse apo njësitë teknike të veçanta para datës 29 prill 2009 dhe as pengon zgjerimin e këtyre miratimeve.

7. DPSHTRR-ja do të pranojë kërkesa për miratimin e tipit KE kur Republika e Shqipërisë të jetë shtet anëtar.

Neni 46

Gjobat

Gjobat e zbatueshme për shkeljen e dispozitave të këtij udhëzimi dhe të direktivës 2007/46/KE janë të përcaktuara në ligjin nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”. Çdo shtet anëtar duhet të njoftojë lidhur me gjobat për shkeljen e dispozitave të direktivës 2007/46/KE, Komisionin jo më vonë se 29 prill 2009 dhe të njoftojnë çdo ndryshim të mëvonshëm të tyre sa më shpejt të jetë e mundur.

Neni 47

Vlerësimi

1. Jo më vonë se data 29 prill 2011, shtetet anëtare informojnë Komisionin për zbatimin e procedurave të miratimit të tipit të parashikuara në direktivën 2007/46/KE dhe veçanërisht për zbatimin e procesit me shumë faza. Sipas rastit, Komisioni propozon ndryshimet e konsideruara të nevojshme për të përmirësuar procesin e miratimit të tipit.

2. Mbi bazën e informacionit të dhënë sipas paragrafit 1, Komisioni i raporton Parlamentit European dhe Këshillit për zbatimin e direktivës 2007/46/KE jo më vonë se data 29 tetor 2011. Sipas rastit, Komisioni mund të propozojë shtyrjen e zbatimit të datave të përmendura në nenin 45.

Neni 48

Transpozimi

1. Shtetet anëtare miratojnë dhe shpallin para datës 29 prill 2009 ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative të nevojshme për të respektuar ndryshimet lëndore të direktivës 2007/46/KE. Ata i komunikojnë Komisionit menjëherë tekstin e dispozitave.

Ata i zbatojnë këto dispozita që nga data 29 prill 2009.

Kur shtetet anëtare miratojnë këto dispozita, këto përmbajnë një referencë të kjo direktivë ose shoqërohen nga një referencë me rastin e shpalljes të tyre zyrtare. Ato përmbajnë gjithashtu një deklaram që referencat në ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative ekzistuese të kjo direktivë të shfuqizuara nga kjo direktivë interpretohen si referenca të kjo direktivë. Shtetet anëtare përcaktojnë si bëhet kjo referencë dhe si formulohet ky deklaram.

2. Shtetet anëtare i komunikojnë Komisionit tekstin e dispozitave kryesore të ligjit të brendshëm që ata miratojnë në fushën e mbuluar nga direktiva 2007/46/KE.

Neni 49 **Shfuqizimi**

Direktiva 70/156/EEC shfuqizohet duke pasur fuqi nga data 29 prill 2009, pa cenuar detyrimet e shteteve anëtare në lidhje me afatet kohore për transpozimin në ligjin e brendshëm dhe zbatimin e direktivave të përcaktuara në pjesën B të shtojcës XX.

Referencat në direktivën e shfuqizuar interpretohen si referenca në direktivën 2007/46/KE dhe lexohen në pajtim me tabelën e ndërlidhjes së përcaktuar në shtojcën XXI të këtij udhëzimi.

Neni 50 **Hyrja në fuqi**

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

SHTOJCA I LISTA E PLOTË E INFORMACIONIT PËR QËLLIMIN E MIRATIMIT TË TIPIT KE TË MJETEVE

Të gjitha dokumentet e informacionit në këtë udhëzim, në harmoni me direktivën 2007/46/KE dhe në direktiva ose rregullore të veçanta duhet të përbëhen vetëm nga pjesë dhe të respektojnë sistemin e numërtimit të kësaj liste të plotë.

Informacioni i mëposhtëm, sipas rastit, duhet të jepet në tri kopje dhe të përfshijë një listë të përmbajtjes. Çdo skicë duhet të jepet në shkallën e duhur dhe me hollësi të mjaftueshme në një format A4 ose e palosura në një format A4. Nëse ka fotografi, këto duhet të tregojnë hollësi të mjaftueshme.

Nëse sistemet, pjesët përbërëse, njësitë e veçanta teknike kanë kontrolle elektronike, duhet të jepet informacioni në lidhje me funksionimin e tyre.

(Për shënime shpjeguese, jeni të lutur t'i referoheni faqes së fundit të kësaj shtojce.)

0. TË PËRGJITHSHME

0.1 Marka e fabrikës (emri i firmës së prodhuesit):

0.2 Tipi:

0.2.0.1 Shasia:

0.2.0.2 Trupi/mjeti i përfunduar:

0.2.1 Emër(a) tregtar(ë) (sipas rastit):

0.3 Mjeti i identifikimit të tipit, nëse është i shënuar në mjet/pjesë përbërëse / njësi teknike të veçantë (b) (1):

0.3.0.1 Shasia:

0.3.0.2 Trupi/mjeti i përfunduar:

0.3.1 Vendndodhja e atij shënimi:

0.3.1.1 Shasia:

0.3.1.2 Trupi/mjeti i përfunduar:

0.4 Kategoria e mjetit (c):

0.4.1 Klasifikimi(et) sipas mallrave të rrezikshëm që mjeti është i destinuar të transportojë:

- 0.5 Emri dhe adresa e prodhuesit:
- 0.6 Vendndodhja dhe metoda e vendosjes së tabelave të detyrueshme dhe vendndodhja e numrit të identifikimit të mjetit
 - 0.6.1 Në shasi:
 - 0.6.2 Në trup:
- 0.7 Në rastin e pjesëve përbërëse dhe njërive teknike të veçanta, vendndodhja dhe metoda e vendosjes së shenjës së miratimit të tipit KE:
- 0.8 Emri(at) dhe adresa(t) e fabrikës(ave) të montimit:
- 0.9 Emri dhe adresa e përfaqësuesit të prodhuesit (sipas rastit):
- 1. KARAKTERISTIKAT E NDËRTIMIT TË PËRGJITHSHËM TË MJETIT
 - 1.1 Fotografi dhe/ose skica të një mjeti përfaqësues:
 - 1.2 Skicë dimensionale e të gjithë mjetit:
 - 1.3 Numri i akseve dhe rrotave:
 - 1.3.1 Numri dhe pozicioni i akseve me rrota dyshe:
 - 1.3.2 Numri dhe pozicioni i akseve të drejtimit:
 - 1.3.3 Akset aktive (numri, pozicioni, ndërlidhja):
 - 1.4 Shasia (sipas rastit (skicë e përgjithshme):
 - 1.5 Materiali i përdorur për elementet anësore (d):
 - 1.6 Pozicioni dhe vendosja e motorit:
 - 1.7 Kabina e drejtimit (me drejtim në krye ose me kofano) (z):
 - 1.8 Krahu i drejtimit: majtas/djathtas (1).
 - 1.8.1 Mjet i pajisur për t'u drejtuar në trafikun e krahut të djathtë/majtë (1).
 - 1.9 Specifikoni nëse mjeti motorik është i destinuar për të tërhequr gjysmërimorkio ose rimorkio të tjera dhe, nëse rimorkioja është gjysmërimorkio, me aks drejtimi ose me aks qendre, specifikoni nëse mjetet janë të destinuara për transportin e mallrave me një temperaturë të kontrolluar:
- 2. MASAT DHE DIMENSIONET (e) (në kg dhe mm) (referojuni skicës sipas rastit)
 - 2.1 Baza(t) e rrotave (me peshë të plotë) (f):
 - 2.1.1 Në rastin e gjysmërimorkiove
 - 2.1.1.1 Distanca ndërmjet aksit të grushtit të drejtimit dhe pjesës fundore të gjysmërimorkios:
 - 2.1.1.2 Distanca ndërmjet aksit të grushtit të drejtimit dhe çdo pike të përparme të gjysmërimorkios:
 - 2.1.1.3 Baza e veçantë e rrotave e gjysmërimorkios (siç përcaktohet në seksionin 7.6.1.2 të shtojcës I të direktivës 97/27/KE):
 - 2.2 Në rastin e mjeteve rimorkiuese të gjysmërimorkiove
 - 2.2.1 Dalja e rrotës së pestë (maksimale dhe minimale; tregoni vlerat e lejueshme në rastin e mjetit të pakompletuar) (g):
 - 2.2.2 Lartësia maksimale e rrotës së pestë (standardizuar) (h):
 - 2.3 Gjurma(t) dhe gjerësia(të) e aksit:
 - 2.3.1 Gjurma e secilit aks të drejtimit (i):
 - 2.3.2 Gjurma e të gjitha akseve të tjera (i):
 - 2.3.3 Gjerësia më e madhe e aksit të pasmë:
 - 2.3.4 Gjerësia e aksit të përparmë (matur në anën e jashtme të gomave duke përjashtuar fryrjen e gomave afër tokës):
 - 2.4 Gama e dimensioneve të mjetit (e përgjithshme)
 - 2.4.1 Për shasinë pa trupin
 - 2.4.1.1 Gjatësia (j):
 - 2.4.1.1.1 Gjatësia më e madhe e lejueshme:
 - 2.4.1.1.2 Gjatësia më e vogël e lejueshme:
9.11.3 Skicime të pjesëve të sipërfaqes së jashtme në pajtim me shtojcën I, pika 6.9.1 të direktivës 74/483/KEE:

9.11.4 Skicim i parokolpeve:

9.11.5 Skicim i linjës së dyshemesë:

9.12 Rripat e sigurimit dhe/ose sisteme të tjera kufizuese

9.12.1 Numri dhe pozicioni i rripave të sigurisë dhe sistemeve të kufizimit në të cilat ato mund të përdoren:

| | Shenjë e plotë miratimi tipi KE | Variant, sipas rastit | Instrument përshatjeje rripi për lartësinë (tregoni po/jo/opsionale) |
|---------------------------|--|-----------------------|--|
| Radha e dytë e ndenjësëve | $\left\{ \begin{array}{l} L \\ C \\ R \end{array} \right.$ | | |
| | | | |
| | | | |
| Radha e parë e ndenjësëve | $\left\{ \begin{array}{l} L \\ C \\ R \end{array} \right.$ | | |
| | | | |
| | | | |

(L = ana e majtë, R = ana e djathtë, C = qendër)

(1) Tabela mund të zgjerohet sipas nevojës për mjetet me më shumë se dy radhë ndenjësesh ose nëse ka më shumë se tri ndenjësë në gjerësinë e mjetit.

9.12.2 Natyra dhe pozicioni i sistemeve kufizuese suplementare (tregoni po / jo / opsionale):

| | Jastëk ajri i parë | Jastëk ajri anësor | Instrument shtrengues i rripit |
|-------------------------------|--|--------------------|--------------------------------|
| Radha e parë e ndenjësëve | $\left\{ \begin{array}{l} L \\ C \\ R \end{array} \right.$ | | |
| | | | |
| | | | |
| Radha e dytë e ndenjësëve (1) | $\left\{ \begin{array}{l} L \\ C \\ R \end{array} \right.$ | | |
| | | | |
| | | | |

(L = ana e majtë, R = ana e djathtë, C = qendër)

(1) Tabela mund të zgjerohet sipas nevojës për mjetet me më shumë se dy radhë ndenjësesh ose nëse ka më shumë se tri ndenjëse në gjerësinë e mjetit.

9.12.3 Numri dhe pozicioni i fiksuesve të rripave të sigurimit dhe prova e respektimit të direktivës 76/115/KEE, (d.m.th., numri i miratimit të tipit KE ose raporti i fundit):

9.12.4 Një përshkrim i shkurtër i pjesëve përbërëse elektrike/elektronike (sipas rastit):

9.13 Fiksues të rripave të sigurimit

9.13.1 Fotografi dhe/ose skica të trupit që tregon pozicionin dhe dimensionet e fiksuesve aktualë dhe të efektshëm duke përfshirë pikat R:

9.13.2 Skicime të fiksuesve të rripave dhe pjesëve të strukturës së mjetit ku ata janë fiksuar (duke treguar materialin):

9.13.3 Përcaktimi i tipave (**), të rripave të sigurimit të autorizuar për t'u futur në fiksues me të cilët është i pajisur mjeti.

| | | | Vendndodhja e fiksimit | |
|---|--|------------------------|------------------------|-----------------------|
| | | | Struktura e mjetit | Struktura e ndenjësës |
| Radha e parë e ndenjësëve
Sedilja e krahut të djathtë | { Fiksime të poshtme
Fiksime të sipërme | { jashtë /
brenda | | |
| Ndenjëse e mesit | { Fiksime të poshtme
Fiksime të sipërme | { djathtas
/ majtas | | |
| Ndenjëse e krahut të majtë | { Fiksime të poshtme
Fiksime të sipërme | { jashtë /
brenda | | |
| Radha e dytë e ndenjësëve [1]
Ndenjëse e krahut të djathtë | { Fiksime të poshtme
Fiksime të sipërme | { jashtë /
brenda | | |
| Ndenjëse e mesit | { Fiksime të poshtme
Fiksime të sipërme | { djathtas
/ majtas | | |
| Ndenjëse e krahut të majtë | { Fiksime të poshtme
Fiksime të sipërme | { jashtë /
brenda | | |

9.13.4 Përshkrimi i një tipi të caktuar rripi sigurie nëse fiksuesi gjendet në mbështetësen e prapme dhe përfshin një instrument për përfitim energjie:

9.14 Hapësirën për montimin e targave të prapme (jepni gamën, sipas rastit, skicimet duhet të përdoren sipas rastit)

9.14.1 Lartësia nga sipërfaqja e rrugës, ana e sipërme:

(1) Tabela mund të zgjerohet sipas nevojës për mjetet me më shumë se dy radhë ndenjësesh ose nëse ka më shumë se tri ndenjëse në gjerësinë e mjetit.

9.14.2 Lartësia nga sipërfaqja e rrugës, ana e poshtme:

9.14.3 Distanca e linjës së qendrës nga plani gjatësor i mjetit:

9.14.4 Distanca nga ana e majtë e mjetit:

9.14.5 Dimensionet (gjatësia × gjerësia):

9.14.6 Tendencat e planit me vertikalen:

9.14.7 Këndi i fushë-pamjes në plan horizontal:

9.15 Mbrojtja e prapme nga poshtë (direktiva 70/221/KEE)

9.15.0 Prania: po/jo/e paplotë (1)

9.15.1 Skicimi i pjesëve të mjetit në lidhje me mbrojtjen e prapme nga poshtë, d.m.th., skicimi i mjetit dhe/ose shasisë me pozicionin dhe montimin e aksit më të gjerë të pasmë, skicimin e montimit dhe/ose vendosjen e mbrojtjes së pasme nga poshtë. Nëse mbrojtja e poshtme nuk është një instrument i veçantë, skica duhet të tregojë qartë që përmbushen dimensionet e kërkuara:

9.15.2 Në rastin e një instrumenti të veçantë, përshkrimi i plotë dhe/skicimi i mbrojtjes së prapme nga poshtë (duke përfshirë montimin dhe vendosjet), ose nëse aprovohet si njësi e veçantë teknike, numrin e miratimit të tipit KE:

9.16 Mbrojtjet e rrotave (direktiva 78/549/KEE)

9.16.1 Përshkrimi i shkurtër i mjetit në lidhje me mbrojtësit e rrotave:

9.16.2 Skicime të detajuara të mbrojtësve të rrotës dhe pozicioni i tyre në mjet duke treguar dimensionet e specifikuar në figurën 1 të shtojcës I të direktivës 78/549/KEE dhe duke marrë parasysh ekstremet e kombinimeve gomë/rrotë:

9.17 Pllakate të detyrueshme (direktiva 76/114/KEE)

9.17.1 Fotografi dhe/ose skicime të vendndodhjes së pllakateve dhe shkrimeve të detyrueshme dhe të numrit të identifikimit të mjetit:

9.17.2 Fotografi dhe/ose skicime të pjesës zyrtare të pllakateve dhe shkrimeve (shembull i përfunduar me përmasa):

9.17.3 Fotografi dhe/ose skicime të numrit të identifikimit të mjetit (shembull i përfunduar me përmasa):

9.17.4 Deklaratë e prodhuesit për përputhshmërinë me kërkesën e pikës 1.1.1 të shtojcës II të direktivës 76/114/KEE

9.17.4.1 Të shpjegohet kuptimi i tipareve në seksionin e dytë dhe, sipas rastit, në seksionin e tretë të përdorura për të respektuar kërkesat e seksionit 5.3 të standardit ISO 3779-1983:

9.17.4.2 Nëse tiparet në seksionin e dytë përdoren për të respektuar kërkesat e seksionit 5.4 të standardit ISO 3779-1983, këto tipare duhet të tregohen:

9.18 Pengimi i interferencës së radios

9.18.1 Përshkrimi dhe skicimi/fotografitë e formave dhe materialeve përbërëse të pjesës së trupit që përbëjnë folenë e motorit dhe pjesën e hapësirës së pasagjerëve më të afërt me të:

9.18.2 Skica ose fotografi të pozicionit të pjesëve përbërëse metalike të vendosura në folenë e motorit (p.sh., instrumentet e ngrohjes, goma rezervë, mekanizmi i drejtimit etj.):

9.18.3 Tabela dhe skicim i pajisjeve të kontrollit të interferencës së radios:

9.18.4 Hollësi dhe vlera nominale e rezistencës së drejtpërdrejtë të korrentit dhe, në rastin e kabllave rezistuese të ndezjes, rezistencën e tyre nominale për metër:

9.19 Mbrojtja anësore (direktiva 89/297/KEE)

9.19.0 Prezenca: po/jo/e paplotë (1)

9.19.1 Skica e pjesëve të mjetit në lidhje me mbrojtjen anësore, d.m.th., skica e mjetit dhe/ose shasisë me pozicionin dhe montimin e aksit(ëve), skicën e montimit dhe/vendosjen e instrumentit(ëve) të mbrojtjes anësore. Nëse mbrojtja anësore arrihet pa instrumente të mbrojtjes anësore, skica duhet të tregojë që përmbushen përmasat e kërkuara

9.19.2 Në rastin e instrumentit(ëve) të mbrojtjes anësore, përshkrim i plotë dhe/ose skicë e këtij instrumenti(ëve) (duke përfshirë montimet dhe vendosjet) ose numri(at) e miratimit të tipit KE të pjesës përbërëse:

9.20 Sistemi i pengimit të spërkatjes (direktiva 91/226/KEE)

9.20.0 Prezenca: po/jo/e paplotë (1)

9.20.1 Përshkrim i shkurtër i mjetit në lidhje me sistemin e pengimit të spërkatjes dhe pjesët përbërëse:

9.20.2 Skicim i detajuar i sistemit të pengimit të spërkatjes dhe pozicioni i tij në mjet duke treguar përmasat e përcaktuara në figurat e shtojcës III të direktivës 91/226/KEE dhe duke marrë parasysh ekstremet e kombinimeve të gomave/rrotave:

9.20.3 Numri(at) e miratimit të tipit KE të mjeteve të pengimit të spërkatjes, sipas rastit:

9.21 Rezistenca e ndikimit anësor (direktiva 96/27/KE)

9.21.1 Duhet të jepet një përshkrim i hollësishëm, duke përfshirë fotografi dhe/ose skica, të mjetit në lidhje me strukturën, përmasat, linjat dhe materialet përbërëse të mureve anësore të pjesës së pasagjerëve (të jashtme dhe të brendshme), duke përfshirë hollësi specifike për sistemin e mbrojtjes, sipas rastit:

9.22 Mbrojtja e përparme nga poshtë

9.22.1 Skica e pjesëve të mjetit në lidhje me mbrojtjen e përparme nga poshtë, d.m.th., skica e mjetit dhe/ose shasia me pozicionin dhe montimin dhe/ose vendosjen e mbrojtjes së përparme nga poshtë. Nëse mbrojtja e përparme nga poshtë nuk ka instrument të veçantë, skica duhet të tregojë që përmbushen përmasat e kërkuara

9.22.2 Në rastin e instrumentit të veçantë, përshkrimi i plotë dhe/skica e mbrojtjes së përparme nga poshtë (duke përfshirë montimin dhe vendosjet), ose nëse është i miratuar si njësi teknike e veçantë, numri i miratimit të tipit KE:

9.23 Mbrojtja e kalimtarëve

9.23.1 Duhet të jepet një përshkrim i hollësishëm, duke përfshirë fotografi dhe/ose skica, të mjetit në lidhje me strukturën, përmasat, linjat përkatëse të referencës dhe materialet përbërës të pjesës së përparme të mjetit (të brendshme dhe të jashtme). Ky përshkrim duhet të përfshijë hollësi për çdo sistem mbrojtjeje aktive të instaluar.

10. INSTRUMENTET E NDRIÇIMIT DHE SINJALIZIMIT ME DRITA

10.1 Tabela e të gjitha instrumenteve: numri, marka e fabrikës, modeli, shenja e miratimit të tipit KE, intensiteti maksimal i fenerëve, ngjyra, ndriçuesit e kontrollit:

10.2 Skicimi i pozicionit të instrumenteve të ndriçimit dhe sinjalizimit me drita:

10.3 Për çdo llambë dhe reflektor të specifikuar në direktivën 76/756/KEE jepni informacionin e mëposhtëm (me shkrim dhe/ose me diagrame)

10.3.1 Skicë që tregon masën e sipërfaqes së ndriçuar:

10.3.2 Metoda e përdorur për përcaktimin e sipërfaqeve të dukshme (paragrafi 2.10 të dokumenteve të përmendur në shtojcën II të direktivës 76/756/KEE, pika 1):

10.3.3 Aksi i referencës dhe qendra e referencës:

10.3.4 Metoda e operimit të llambave që mbulohen:

10.3.5 Çdo dispozitë e posaçme për montimin dhe kabllot:

10.4 Dritat e shkurtra: orientimi normal sipas paragrafit 6.2.6.1 të dokumenteve të përmendur në shtojcën II të direktivës 76/756/KEE, pika 1

10.4.1 Vlera e përshtatjes fillestare:

10.4.2 Vendndodhja e treguesit:

10.4.3 Përshkrim/skicim (1) dhe tipi i instrumentit të nivelimit të llambave të para (p.sh., automatike, të përshtatshme me shkallë manualisht, të përshtatshme manualisht në mënyrë të vazhdueshme): ...

10.4.4 Instrumenti i kontrollit: ...

10.4.5 Shenjat e referencës: ...

10.4.6 Shenjat e caktuara për kushtet e ngarkesës: ...

10.5 Një përshkrim i shkurtër i pjesëve përbërëse elektrike/elektronike të ndryshme nga llambat (sipas rastit):

E zbatueshme vetëm për mjetet me instrument për nivelimin e llambave të para

11. LIDHJET NDËRMJET MJETEVE RIMORKIUESE DHE RIMORKIOVE DHE GJYSMËRIMORKIOVE

11.1 Klasa dhe tipi i instrumentit(eve) të takimit të instaluar ose që duhet të instalohet:

11.2 Karakteristikat D, U, S dhe V të instrumentit(eve) të takimit të instaluar ose karakteristikat minimale D, U, S dhe V të instrumentit(eve) që duhen instaluar: ... daN

11.3 Udhëzimet për bashkimin e tipit të takimit në mjet dhe fotografi ose skica të pikave të takimit në mjete, siç deklarohen nga prodhuesi; informacion shtesë, nëse përdorimi i tipit të takimit kufizohet në variante të caktuara ose versione të tipit të mjetit:

11.4 Informacion i instalimit të mbështetëseve të veçanta të rimorkimit ose pllakave të montimit:

11.5 Numri(at) e miratimit të tipit KE

12. TË NDRYSHME

12.1 Instrument(e) paralajmërues(e) zanor(e)

12.1.1 Vendndodhja, metoda e bashkimit, vendosjes dhe orientimit të instrumentit(eve), me dimensionet:

12.1.2 Numri i instrumentit(eve):

12.1.3 Numri(at) e miratimit të tipit KE:

12.1.4 Diagrami i qarkut elektrik/pneumatik (1)

12.1.5 Vlera nominale e voltazhit ose presionit:

12.1.6 Skicimi i instrumentit të montimit:

12.2 Instrumentet për parandalimin e përdorimit të paautorizuar të mjetit

12.2.1 Instrument mbrojtës

12.2.1.1 Një përshkrim i hollësishëm i tipit të mjetit në lidhje me rregullimin dhe dizenjon e kontrollit ose të të njësisë ku vepron instrumenti i mbrojtjes:

- 12.2.1.2 Skicimet e instrumentit mbrojtës dhe të montimit të tij në mjet:
- 12.2.1.3 Një përshkrim teknik të instrumentit:
- 12.2.1.4 Hollësi për kombinacionet e bravave të përdorura:
- 12.2.1.5 Bllokuesit e mjeteve
 - 12.2.1.5.1 Numri i miratimit të tipit KE, sipas rastit:
 - 12.2.1.5.2 Për bllokuesit e pa miratuar ende
 - 12.2.1.5.2.1 Një përshkrim teknik i hollësishëm i bllokuesit të mjetit dhe të masave të marra kundër aktivizimit të pavullnetshëm:
 - 12.2.1.5.2.2 Sistemi(et) ku vepron bllokuesi i mjetit:
 - 12.2.1.5.2.3 Numri i kodeve efektivë të këmblyeshëm, sipas rastit:
- 12.2.2 Sistemi i alarmit (sipas rastit)
 - 12.2.2.1 Numri i miratimit të tipit KE, sipas rastit:
 - 12.2.2.2 Për sistemet e alarmit që nuk janë aprovuar akoma
 - 12.2.2.2.1 Një përshkrim i hollësishëm i sistemit të alarmit dhe e pjesëve të mjetit në lidhje me sistemin e alarmit të instaluar:
 - 12.2.2.2.2 Një listë të pjesëve kryesore përbërëse që përbëjnë sistemin e alarmit:
- 12.2.3 Një përshkrim i shkurtër i pjesëve përbërëse elektrike/elektronike (sipas rastit):
- 12.3 Instrumenti(et) e rimorkimit
 - 12.3.1 Përpara: ganxhë/unazë/tjetër (1)
 - 12.3.2 Prapa: ganxhë/unazë/tjetër (1)
 - 12.3.3 Skicim ose fotografim i shasisë/zonës së trupit të mjetit që tregon pozicionin, ndërtimin dhe montimin e instrumentit(eve) të rimorkimit:
- 12.4 Hollësi të çdo instrumenti që nuk lidhet me motorin që ka ndikim mbi konsumin e karburantit (nëse nuk mbulohet nga pikat e tjera):
- 12.5 Hollësi të çdo instrumenti që nuk lidhet me motorin që ka ndikim mbi reduktimin e zhurmës (nëse nuk mbulohet nga pikat e tjera)
- 12.6 Kufizuesit e shpejtësisë (direktiva 92/24/KEE)
 - 12.6.1 Prodhuesi(t):
 - 12.6.2 Tipi(at):
 - 12.6.3 Numri(at) e miratimit të tipit KE, sipas rastit:
 - 12.6.4 Shpejtësia ose gamat e shpejtësive me të cilat mund të vendoset kufizimi i shpejtësisë: ... km/h

12.7. Tabela e instalimit dhe përdorimit të transmetuesve RF në mjet(e), sipas rastit:

| Valët e frekuencave (Hz) | fuqia maksimale (W) | pozicioni i antenës në mjet, kushte specifike për instalim dhe/ose përdorim |
|--------------------------|---------------------|---|
|--------------------------|---------------------|---|

Kërkuesi për miratimit të tipit duhet të paraqesë, sipas rastit:

Shtojca 1

Një listë me emrin(at) e fabrikës dhe tipit(at) e të gjitha pjesëve përbërëse elektrike dhe/ose elektronike të parashikuara nga direktiva 2007/46/KE (shih pikat 2.1.9. dhe 2.1.10. të direktivës 2004/104/KE) dhe që nuk janë renditur më parë.

Shtojca 2

Skema ose skica e rregullimit të përgjithshëm të pjesëve përbërëse elektrike dhe/ose elektronike (parashikuar nga direktiva 2004/104/KE) dhe vendosja e përgjithshme e kablllove.

Shtojca 3

Përshkrim i mjetit të zgjedhur për të përfaqësuar tipin

Varianti i karrocërisë:

Me timon në krahun e majtë ose të djathtë:

Baza e rrotave:

Shtojca 4

Raport(e) përkatës(e) testimi të dhëna nga prodhuesi ose laboratorët e miratuar/njohur për qëllimin e përpilimit të certifikatës së miratimit tipit.

12.7.1 Mjet i pajisur me një pajisje me radar me rreze të shkurtër 24 GHz: po/jo (fshi atë që nuk duhet).

12.7.2 Mjet i pajisur me një pajisje me radar me rreze të shkurtër 79 GHz: po/jo (fshi atë që nuk duhet)

13. DISPOZITA TË VEÇANTA PËR MJETET E PËRDORURA PËR TRANSPORTIMIN E PASAGJERËVE QË KANË MË SHUMË SE TETË NDENJËSE PËRVEÇ NDENJËSES SË SHOFERIT

13.1 Klasa e mjetit (klasa I, klasa II, klasa III, klasa A, klasa B):

13.1.1 Numri i miratimit të tipit KE të karrocërës të miratuar si njësi teknike e veçantë: ...

13.1.2 Tipat e shasive ku mund të montohet karrocëria e miratuar e tipit KE (prodhuesi(t), dhe tipat e mjeteve të pakompletuara):

13.2 Hapësira e pasagjerëve (m²)

13.2.1 Totali (S0):

13.2.2 Bordi i sipërm (S0a) (1):

13.2.3 Bordi i poshtëm (S0b) (1):

13.2.4 Për pasagjerët në këmbë (S1):

13.3 Numri i pasagjerëve (të ulur dhe në këmbë)

13.3.1 Totali (N):

13.3.2 Bordi i sipërm (Na) (1):

13.3.3 Bordi i poshtëm (Nb) (1):

13.4 Numri i pasagjerëve të ulur

13.4.1 Totali (A):

13.4.2 Bordi i sipërm (Aa) (1):

13.4.3 Bordi i poshtëm (Ab) (1):

13.5 Numri i dyerve të shërbimit:

13.6 Numri i daljeve të emergjencës (dyer, dritare, baxhë, shkallë dhe gjysmëshkallë ndërkomunikuese):

13.6.1 Totali:

13.6.2 Bordi i sipërm (1):

13.6.3 Bordi i poshtëm (1):

13.7 Vëllimi i hapësirës së bagazhit (m³):

13.8 Sipërfaqja e transportimit të bagazhit mbi çati (m²):

13.9 Instrumentet teknike që lehtësojnë hyrjen në mjet (p.sh., pjesë të pjerrëta, platformë ngritëse, sistem për ulje), sipas rastit:

13.10 Fuqia e superstrukturës

13.10.1 Numri i miratimit të tipit KE, sipas rastit:

13.10.2 Për superstrukturat që nuk janë miratuar ende

13.10.2.1 Përshkrim i hollësishëm i superstrukturës së tipit të mjetit duke përfshirë përmasat, konfigurimin dhe materialet përbërëse dhe bashkimin e saj në çdo pjesë të shasisë:

13.10.2.2 Skicime të mjetit dhe të atyre pjesëve të rregullimit të brendshëm që kanë ndikim në fuqinë e superstrukturës ose në ambientin e pasagjerëve:

13.10.2.3 Pozicioni i qendrës së gravitetit të mjetit në gjendje funksionale në drejtimet gjatësore, tërthore dhe vertikale.

13.10.2.4 Largësia maksimale ndërmjet vijave të qendrës të ndenjësive të jashtme të pasagjerëve:

13.11 Pikat e direktivës [.../.../KE] të shoqërohen dhe demonstrohen për këtë njësi teknike:

14. DISPOZITA TË VEÇANTA TË DESTINUARA PËR TRANSPORTIN E MALLRAVE TË RREZIKSHËM (direktiva 98/91/KE)

14.1 Pajisjet elektrike sipas direktivës 94/55/KE

14.1.1 Masat mbrojtëse ndaj mbinxehjes së përcjellësve:

14.1.2 Tipi i çelësit ndarës:

14.1.3 Tipi dhe operimi i çelësit kryesor të baterisë:

14.1.4 Përshkrimi dhe vendndodhja e barrierës së sigurisë së takografit:

14.1.5 Përshkrimi i instalimeve me energji të përhershme. Tregoni standardin EN të zbatuar.

14.1.6 Ndërtimi dhe mbrojtja e instalimeve elektrike që gjenden prapa kabinës të shoferit:

14.2 Parandalimi i rreziqeve të zjarrit

- 14.2.1 Tipi i materialit zjarrdurues në kabinën e shoferit:
- 14.2.2 Tipi mbrojtëses nga nxehtësia prapa kabinës së shoferit (sipas rastit):
- 14.2.3 Pozicioni dhe mbrojtja nga nxehtësia e motorit:
- 14.2.4 Pozicioni dhe mbrojtja nga nxehtësia e sistemit të shkarkimit:
- 14.2.5 Tipi dhe projekti i mbrojtjes nga nxehtësia e sistemit të qëndrueshëm të frenimit:
- 14.2.6 Tipi, projekti dhe pozicioni i nxehtësve shtesë:
- 14.3 Kërkesa të veçantë për trupin, sipas rastit, në pajtim me direktivën 94/55/KE
- 14.3.1 Përshkrimi i masave për të përmbushur kërkesat e mjeteve të tipit EX/II dhe të tipit EX/III:
- 14.3.2 Në rastin e mjeteve të tipit EX/III, rezistenca ndaj nxehtësisë nga jashtë:
- Shënime shpjeguese
- (*) Jeni të lutur të mbushni vlerat maksimale dhe minimale për çdo variant.
- (**) Për simbolet dhe shenjat që përdoren, shih shtojcën III, pikat 1.1.3 dhe 1.1.4 të direktivës 77/541/KEE. Në rastin e rripave të tipit “S”, specifikoni natyrën e tipit (ave).
- (***) Informacioni në lidhje me pjesët përbërëse nuk është i nevojshëm të jepet, nëse ky informacion është i përfshirë në certifikatën përkatëse të miratimit të instalimit.
- (+) Mjetet mund të furnizohen me karburant të lëngshëm dhe të gaztë por, nëse sistemi i lëngshëm është instaluar vetëm për qëllime emergjence ose vetëm për ndezje dhe serbatori merr vetëm 15 litra karburant të lëngshëm, ato konsiderohen për testin si mjete që mund të punojnë vetëm me karburant të gaztë.
- (+ + +) Vetëm për qëllimin e përkufizimit të mjeteve fuoristradë.
- (#) Përcaktuar në mënyrë të tillë që të qartësohet vlera aktuale për çdo konfigurim teknik të tipit të mjetit.
- (1) Fshijeni nëse nuk zbatohen (ka raste ku nuk duhet fshirë asgjë nëse aplikohet më shumë se një e dhënë).
- (2) Përcaktoni tolerancën.
- a) Nëse një pjesë është e miratuar si tip, ajo pjesë nuk është e nevojshme të përshkruhet nëse bëhet referencë te një miratim i tillë. Po ashtu, një pjesë nuk është e nevojshme të përshkruhet nëse ndërtimi i saj është qartazi i dukshëm nga diagramet dhe skicat e hequra. Për secilin artikull të cilit i duhen bashkëngjitur skicime dhe fotografi, jepni numrat e dokumenteve përkatës të bashkëngjitur.
- b) Nëse cilësitë e identifikimit të tipit përmbajnë tipare që nuk janë thelbësore për të përshkruar mjetin, pjesën përbërëse ose njësinë e veçantë teknike të mbuluar nga ky dokument informacioni, këto tipare përfaqësohen në dokumentacion me simbolin “?” (p.sh., ABC??123??).
- c) Klasifikuar në pajtim me përkufizimet e renditura në shtojcën II, seksioni A.
- d) Nëse është e mundur, përcaktimi në pajtim me euro-normën; nëse jo, jepni:
- përshkrimin e materialit,
 - kufirin e shtrirjes,
 - qëndrueshmëria,
 - zgjatja (në %),
 - fortësia Brinell.
- e) Nëse ka një version me një kabinë normale dhe një tjetër me një kabinë për fjetje, duhet të jepen të dyja kompletet e masave dhe dimensioneve.
- f) Standardi ISO 612 – 1978, përkufizimi nr.6.4.
- g) Standardi ISO 612 – 1978, përkufizimi nr.6.19.2.
- h) Standardi ISO 612 – 1978, përkufizimi nr.6.20.
- i) Standardi ISO 612 – 1978, përkufizimi nr.6.5.
- j) Standardi ISO 612 – 1978, përkufizimi nr.6.1 dhe për mjetet e ndryshme nga ato të kategorisë M1: direktiva 97/27/KE, shtojca I, seksioni 2.4.1.
- k) Standardi ISO 612 – 1978, përkufizimi nr.6.2 dhe për mjetet e ndryshme nga ato të kategorisë M1: direktiva 97/27/KE, shtojca I, seksioni 2.4.2.
- l) Standardi ISO 612 – 1978, përkufizimi nr.6.3 dhe për mjetet e ndryshme nga ato të kategorisë M1: direktiva 97/27/KE, shtojca I, seksioni 2.4.3.
- m) Standardi ISO 612 – 1978, përkufizimi nr.6.6.
- n) Standardi ISO 612 – 1978, përkufizimi nr.6.7.

- na) Standardi ISO 612 – 1978, përkufizimi nr.6.10.
- nb) Standardi ISO 612 – 1978, përkufizimi nr.6.11.
- nc) Standardi ISO 612 – 1978, përkufizimi nr.6.9.
- nd) Standardi ISO 612 – 1978, përkufizimi nr.6.18.1.
- o) Masa e shoferit dhe, sipas rastit, e anëtarit të ekuipazhit vlerësohet me 75 kg (i ndarë në 68 kg për pasagjerin dhe 7 kg për masën e bagazhit në pajtim me standardin ISO 2416-1992), serbatori është i mbushur me 90% dhe sistemet e tjera që përmbajnë lëngje (përveç atyre që përdoren për ujë) me 100% të kapacitetit të përcaktuar nga prodhuesi.
- p) “Dalja e takimit” është largësia horizontale ndërmjet takimit për rimorkio me aks në qendër dhe vijës qendrore të aksit(eve) të pasmë.
- q) Në rastin e motorëve dhe sistemeve jokonvencionale, hollësitë e barasvlershme me ato të përmendura këtu do të jepen nga prodhuesi.
- r) Kjo shifër duhet të rrumbullakoset deri në të dhjetën më të afërt të një milimetri.
- s) Kjo vlerë duhet të llogaritet ($\pi = 3,1416$) dhe vlerësohet deri në cm³ më të afërt.
- t) Përcaktuar në pajtim me kërkesat e direktivës 80/1269/KEE.
- u) Përcaktuar në pajtim me kërkesat e direktivës 80/1268/KEE
- v) Hollësitë e veçanta duhet të jepen për çdo variant të propozuar.
- w) Lejohet një tolerancë prej 5 %.
- x) “Pika-R” ose “pika e referencës së uljes” është një pikë projekti e përcaktuar nga prodhuesi i mjetit për secilin pozicion uljeje dhe që përcaktohet në lidhje me sistemin e referencave tredimensionale siç specifikohet në shtojcën III të direktivës 77/649/KEE.
- y) Për rimorkiot dhe gjysmërimorkiot dhe për mjetet e takuara me një rimorkio ose gjysmërimorkio, që ushtrojnë një ngarkesë të konsiderueshme vertikale në instrumentin e takimit ose në rrotën e pestë, kjo ngarkesë, e ndarë me përshejtimin standard të gravitetit, përfshihet në masën maksimale teknikisht të lejueshme.
- z) “Kontrolli i përparmë” është një konfigurim në të cilin më shumë se gjysma e gjatësisë së motorit është prapa brinjës së poshtme të xhamit të përparmë dhe bokulla e timonit në një të katërtën e parë të gjatësisë së mjetit.

SHTOJCA II PËRKUFIZIMI I KATEGORIVE TË MJETEVE DHE TIPAVE TË MJETEVE

A. PËRKUFIZIMI I KATEGORIVE TË MJETEVE

Kategoritë e mjeteve përkufizohen në pajtim me klasifikimin e mëposhtëm (nëse bëhet referencë në “masë maksimale” në përkufizimet e mëposhtme, kjo do të thotë “masë maksimale teknikisht e lejueshme e ngarkesës” siç specifikohet në pikën 2.8 të shtojcës I).

I. Kategoria M: Mjetet motorike me të paktën katër rrota të destinuara dhe ndërtuara për transportin e pasagjerëve.

Kategoria M1: Mjetet e projektuara dhe ndërtuara për transportin e pasagjerëve dhe që përbëhen nga jo më shumë se tetë ndenjëse përveç ndenjësës së shoferit.

Kategoria M2: Mjetet e projektuara dhe ndërtuara për transportin e pasagjerëve, dhe që përbëhen nga më shumë se tetë ndenjëse përveç ndenjësës së shoferit dhe që kanë një masë maksimale jo më shumë se 5 tonë.

Kategoria M3: Mjetet e projektuara dhe ndërtuara për transportin e pasagjerëve, dhe që përbëhen nga më shumë se tetë ndenjëse përveç ndenjësës së shoferit dhe që kanë një masë maksimale më shumë se 5 tonë.

Tipat e trupit dhe kodifikimeve në lidhje me mjetet e kategorisë M janë përkufizuar në pjesën C të kësaj shtojce paragrafi 1 (mjetet e kategorisë M1) dhe paragrafi 2 (mjetet e kategorive M2 dhe M3) të përdoret për qëllimin e specifikuar në atë pjesë.

2. Kategoria N: Mjetet motorike me të paktën katër rrota të destinuara dhe ndërtuara për transportin e mallrave.

Kategoria N1: Mjetet e projektuara dhe ndërtuara për transportin e mallrave dhe që kanë një masë maksimale jo më shumë se 3,5 tonë.

Kategoria N2: Mjetet e projektuara dhe ndërtuara për transportin e mallrave dhe që kanë një masë maksimale më shumë se 3,5 tonë, por jo më shumë se 12 tonë.

Kategoria N3: Mjetet e projektuara dhe ndërtuara për transportin e mallrave dhe që kanë një masë maksimale më shumë se 12 tonë.

Në rastin e një mjeti rimorkimi të destinuar të tërheq një gjysmërimorkio ose rimorkio me aks qendre, masa që duhet të konsiderohet për klasifikimin e mjetit është masa e mjetit traktor në gjendje funksionale, e shtuar me masën që i përket ngarkesës vertikale statike maksimale që i transmetohet mjetit traktor nga gjysmërimorkioja ose rimorkioja me aks qendre dhe, sipas rastit, me masën maksimale të ngarkesës së vetë mjetit traktor.

Tipat e trupit dhe kodifikimeve në lidhje me mjetet e kategorive N janë përkufizuar në pjesën C të kësaj shtojce; paragrafi 3 të përdoret për qëllimin e specifikuar në atë pjesë.

3. Kategoria O: Rimorkiot (duke përfshirë gjysmërimorkiot).

Kategoria O1: Rimorkiot me një masë maksimale që nuk kalon 0,75 ton.

Kategoria O2: Rimorkiot me një masë maksimale që kalon 0,75 ton, por më pak se 3,5 tonë.

Kategoria O3: Rimorkiot me një masë maksimale që kalon 3,5 ton, por më pak se 10 tonë.

Kategoria O4: Rimorkiot me një masë maksimale që kalon 10 tonë.

Në rastin e një gjysmërimorkioje ose rimorkioje me aks qendre, masa maksimale që konsiderohet për klasifikimin e rimorkios përputhet me ngarkesën vertikale statike të transmetuar në tokë nga aksi ose akset e gjysmërimorkios ose rimorkios me aks në qendër kur takohet me mjetin rimorkiues dhe mbart ngarkesën maksimale.

Tipat e trupit dhe kodifikimeve në lidhje me mjetet e kategorive O janë përkufizuar në pjesën C të kësaj shtojce; paragrafi 4 të përdoret për qëllimin e specifikuar në atë pjesë.

4. Mjetet fuoristradë (simboli G)

4.1 Mjetet në kategorinë N1 me masë maksimale që nuk kalon dy tonë dhe mjetet në kategorinë M1 konsiderohen mjete fuoristradë nëse kanë:

- të paktën një aks të parë dhe të paktën një aks të pasmë të projektuar për të qenë njëkohësisht aktivë duke përfshirë mjetet ku aktivizimi i një aksi mund të ndërpritet;

- të paktën një mekanizëm bllokimi të diferencialit dhe të paktën një mekanizëm që ka një efekt të ngjashëm, nëse ato mund të ngjisin një pjerrësi të paktën 30% të llogaritur për një mjet të vetëm.

Përveç kësaj, ato duhet të përmbushin të paktën pesë nga gjashtë kërkesat e mëposhtme:

- këndi i përparmë duhet të jetë të paktën 25 gradë;

- këndi i pasmë duhet të jetë të paktën 20 gradë;

- këndi i pjerrësisë duhet të jetë të paktën 20 gradë;

- lartësia nga toka tek aksi i parë duhet të jetë të paktën 180 mm;

- lartësia nga toka tek aksi i pasmë duhet të jetë të paktën 180 mm;

- lartësia nga toka ndërmjet akseve duhet të jetë të paktën 200 mm.

4.2 Mjetet në kategorinë N1 me masë maksimale që kalon dy tonë ose në kategorinë N2, M2 ose M3 me masë maksimale që nuk kalon 12 tonë konsiderohen mjete fuoristradë nëse të gjitha rrotat janë njëkohësisht aktive, duke përfshirë mjetet ku aktivizimi i një aksi mund të ndërpritet, ose nëse përmbushin tri kërkesat e mëposhtme:

- të paktën një aks të parë dhe të paktën një aks të pasmë të projektuar për të qenë njëkohësisht aktivë duke përfshirë mjetet ku aktivizimi i një aksi mund të ndërpritet,

- të paktën një mekanizëm bllokimi të diferencialit dhe të paktën një mekanizëm që ka një efekt të ngjashëm,

- ato mund të ngjisin një pjerrësi të paktën 25% të llogaritur për një mjet të vetëm.

4.3 Mjetet në kategorinë M3 me masë maksimale që kalon 12 tonë ose në kategorinë N3 konsiderohen mjete fuoristradë nëse të gjitha rrotat janë njëkohësisht aktive, duke përfshirë mjetet ku aktivizimi i një aksi mund të ndërpritet, ose nëse përmbushen kërkesat e mëposhtme:

- të paktën gjysmat e rrotave janë aktive;

- ka të paktën një mekanizëm bllokimi të diferencialit dhe të paktën një mekanizëm që ka një efekt të ngjashëm;

- ato mund të ngjisin një pjerrësi të paktën 25% të llogaritur për një mjet të vetëm;

- përmbushin të paktën katër nga gjashtë kërkesat e mëposhtme:

- këndi i përparmë duhet të jetë të paktën 25 gradë;

- këndi i pasmë duhet të jetë të paktën 25 gradë;
- këndi i pjerrësisë duhet të jetë të paktën 25 gradë;
- lartësia nga toka tek aksi i parë duhet të jetë të paktën 250 mm;
- lartësia nga toka tek aksi i pasmë duhet të jetë të paktën 300 mm;
- lartësia nga toka ndërmjet akseve duhet të jetë të paktën 250 mm.

4.4 Kushtet e ngarkesës dhe kontrollit

4.4.1 Mjetet në kategorinë N1 me masë maksimale që nuk kalon dy tonë dhe mjetet në kategorinë M1 duhet të jenë në gjendje pune, d.m.th., me tretësirë ftohëse, lubrifikant, karburant, vegla, gomë rezervë dhe shofer (shih shënimin fundor (o) në shtojcën I).


4.4.2 Mjetet motorike të ndryshme nga ato të përmendura në 4.4.1 duhet të jenë të ngarkuara deri në masën maksimale teknikisht të lejueshme të përcaktuar nga prodhuesi.

4.4.3 Aftësia për të ngjitur pjerrësitë e kërkua (25% dhe 30%) verifikohet me llogaritje të thjeshtë. Megjithatë, në raste të veçanta shërbimet teknike mund të kërkojnë një mjet të tipit përkatës për t'iu paraqitur për një test faktik.

4.4.4 Gjatë matjes së këndeve të parmë dhe të pasmë dhe të këndit të pjerrësisë, nuk merren parasysh mjetet e mbrojtjes nga poshtë.


4.5 Përkufizimet dhe skicat e lartësisë nga toka. (Për përkufizimet e këndit të parmë, këndit të pasmë, këndit të pjerrësisë, shih shtojcën I, shënimet fundore (na), (nb) dhe (nc)).

4.5.1 “Lartësia nga toka ndërmjet akseve” është distanca më e shkurtër ndërmjet planit të tokës dhe pikës më të fortë të qëndrueshme të mjetit. Agregatet me disa akse konsiderohen si një aks i vetëm.



4.5.2 “Lartësia nga toka nën një aks” është distanca ndërmjet pikës më të lartë të harkut të një rrethi që kalon në qendrën e batisradës së gomës së rrotave të aksit (rrotave të brendshme në rastin e gomave dyshe) dhe që prek pikën më të ulët të qëndrueshme të mjetit ndërmjet rrotave.

Asnjë pjesë e mjetit nuk duhet të futet në zonën e hijezuar të diagramit. Sipas rastit, lartësia nga toka e disa akseve tregohet në pajtim me renditjen e tyre, për shembull 280/250/250.



4.6 Përcaktim i kombinuar

Simboli “G” kombinohet me simbolin “M” ose “N”. Për shembull, një mjet i kategorisë N1 që është i përshtatshëm për t’u përdorur si fuoristradë përcaktohet si N1G.

5. “Mjet me qëllim të veçantë” është një mjet që është caktuar të përmbushë një funksion që kërkon masa të veçanta në trup dhe/ose pajisje. Kjo kategori përfshin mjetet ku mund të hipet me karrige me rrota.

5.1 “Rulota” është një mjet i kategorisë M me qëllim të veçantë e ndërtuar për të përfshirë strehimin e personave dhe që përmban të paktën pajisjet e më poshtme:

- vende për t’u ulur dhe tavolinë;
- ambient fjetjeje që mund të konvertohet nga vendet për t’u ulur;

- ambiente gatimi; dhe
- ambiente ruajtjeje.

Këto pajisje nguliten në ambientin e banimit; megjithatë, tavolina mund të projektohet për të qenë lehtësisht e lëvizshme.

5.2 “Mjetet e blinduara” janë mjetet e destinuar për mbrojtjen e pasagjerëve dhe/ose mallrave të transportuar me veshje të blinduar dhe me pajisjet antiplumb.

5.3 “Ambulancat” janë mjetet motorike të kategorisë M për transportin e njerëzve të sëmurë ose të plagosur dhe që kanë pajisje të veçanta për këtë qëllim.

5.4 “Mjete funerali” janë mjetet motorike të kategorisë M të destinuar për transportin e njerëzve të vdekur dhe që kanë pajisje të veçantë për këtë qëllim.

5.5 “Mjete të përshtatshme për karrige me rrota” janë mjetet e kategorisë M1 të ndërtuara ose të konvertuara posaçërisht në mënyrë të tillë që të marrin një ose më shumë person(a) të ulur në karrigen(t) e tyre me rrota gjatë udhëtimit në rrugë.

5.6 “Rulotat rimorkio” shih standardin ISO 3833-77, përkufizimi nr.3.2.1.3.

5.7 “Vinçat e lëvizshëm” janë një mjet i një qëllimi të veçantë i kategorisë N3, që nuk është i përshtatshëm për transportin e mallrave, i pajisur me një vinç, momenti ngritës i të cilit është i barabartë ose më i lartë se 400 kNm.

5.8 “Mjete të tjera për qëllime të veçanta” janë mjetet e përkufizuara në pikën 5 më sipër, me përjashtim të atyre të përmendura në pikat 5.1 deri 5.6.

Kodifikimet që u takojnë “mjetëve me qëllim të veçantë” janë përkufizuar në pjesën C të këtij shtojca; paragrafi 5 të përdoret për qëllimin e specifikuar në atë pjesë.

B. PËRKUFIZIME TË TIPIT TË MJETIT

1. Për qëllimet e kategorisë M1:

Një “tip” përbëhet nga mjetet që nuk ndryshojnë në të paktën aspektet thelbësore të mëposhtme:

- prodhuesi;
- përcaktimi i tipit të prodhuesit;
- aspekte thelbësore të ndërtimit dhe dizenjës;
- shasi/grupi i dyshemesë (ndryshime të dukshme dhe themelore);
- njësia e fuqisë (djegie të brendshme/elektrike/hibride).

“Variant” i një tipi janë mjetet brenda një tipi që nuk ndryshojnë në të paktën aspektet thelbësore të mëposhtme:

- stili i trupit (p.sh. limuzinë, me 5 dyer, kupe, e konvertueshme, me portobagazh, mjet me disa qëllime);

- njësia e fuqisë;
- parimi i punës (si në pikën 3.2.1.1 të shtojcës III);
- numri dhe vendosja e cilindrave;

- diferencat e fuqisë prej më shumë se 30% (më e larta është më shumë se 1,3 herë më shumë se e ulëta);

- diferencat e fuqisë prej më shumë se 20% (më e larta është më shumë se 1,2 herë më shumë se e ulëta);

- akset aktive (numri, pozicioni, ndërlidhja);
- akset e drejtimit (numri dhe pozicioni).

“Versioni” i një varianti janë mjetet që përbëhen nga një kombinim i artikujve të treguar në paketën e informacionit sipas kërkesave në shtojcën VIII.

Disa të dhëna të parametrave të mëposhtëm nuk mund të kombinohen brenda një versioni:

- masa më e madhe teknikisht e lejueshme e ngarkesës;
- kapaciteti i motorit;
- fuqia maksimale neto;
- tipi i kutisë së shpejtësisë dhe numri i marsheve,
- numri maksimal i vendeve për t’u ulur siç përkufizohet në shtojcën II C.

2. Për qëllimet e kategorive M2 dhe M3:

Një “tip” përbëhet nga mjetet që nuk ndryshojnë në të paktën aspektet thelbësore të mëposhtme:

- prodhuesi;
- përcaktimi i tipit të prodhuesit;

- kategoria;
- aspekte thelbësore të ndërtimit dhe dizenjës:
- shasi/trup vetëmbajtës, me një / dy borde, solide/fizarmonikë (ndryshime të dukshme dhe themelore);

- numri i akseve;
- njësia e fuqisë (djegie të brendshme/elektrike/hibride).

“Variant” i një tipi janë mjetet brenda një tipi që nuk ndryshojnë në të paktën aspektet thelbësore të mëposhtme:

- klasë siç përcaktohet në direktivën 2001/85/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të datës 20 nëntor 2001 në lidhje me dispozitat e veçanta për mjetet e përdorura për transportimin e pasagjerëve që përbëhen nga më shumë se tetë ndenjese përveç ndenjësës së shoferit (vetëm për mjetet e kompletuara);

- faza e ndërtimit (p.sh., e kompletuar/e pakompletuar);

- njësia e fuqisë:

- parimi i punës (si në pikën 3.2.1.1 të shtojcës III);

- numri dhe vendosja e cilindrave;

- diferencat e fuqisë prej më shumë se 50% (më e larta është më shumë se 1,5 herë më shumë se e ulëta);

- diferencat e fuqisë prej më shumë se 50% (më e larta është më shumë se 1,5 herë më shumë se e ulëta);

- vendndodhja (para, në mes, prapa);

- diferencat e masës së ngarkesës maksimale teknikisht të lejueshme prej më shumë se 20% (më e larta është më shumë se 1,2 herë më shumë se më e ulëta);

- akset aktive (numri, pozicioni, ndërlidhja);

- akset e drejtimit (numri dhe pozicioni).

“Versioni” i një varianti janë mjetet që përbëhen nga një kombinim i artikujve të treguar në paketën e informacionit sipas kërkesave në shtojcën VIII.

3. Për qëllimet e kategorive N1, N2 dhe N3:

Një “tip” përbëhet nga mjetet që nuk ndryshojnë në të paktën aspektet thelbësore të mëposhtme:

- prodhuesi;

- përcaktimi i tipit të prodhuesit;

- kategoria;

- aspekte thelbësore të ndërtimit dhe dizenjës:

- shasi/trup vetëmbajtës (ndryshime të dukshme dhe themelore);

- numri i akseve;

- njësia e fuqisë (djegie të brendshme/elektrike/hibride).

“Variant” i një tipi janë mjetet brenda një tipi që nuk ndryshojnë në të paktën aspektet thelbësore të mëposhtme:

- Koncepti i ndërtimit të trupit (p.sh., kamion platformë / vetëshkarkuese / autobot / mjet për tërheqjen e gjysmërimorkiove),

- faza e ndërtimit (p.sh., e kompletuar/e pakompletuar),

- njësia e fuqisë:

- parimi i punës (si në pikën 3.2.1.1 të shtojcës III);

- numri dhe vendosja e cilindrave;

- diferencat e fuqisë prej më shumë se 50% (më e larta është më shumë se 1,5 herë më shumë se e ulëta);

- diferencat e fuqisë prej më shumë se 50% (më e larta është më shumë se 1,5 herë më shumë se e ulëta);

- diferencat e masës së ngarkesës maksimale teknikisht të lejueshme prej më shumë se 20% (më e larta është më shumë se 1,2 herë më shumë se më e ulëta);

- akset aktive (numri, pozicioni, ndërlidhja);

- akset e drejtimit (numri dhe pozicioni).

“Versioni” i një varianti janë mjetet që përbëhen nga një kombinim i artikujve të treguar në paketën e informacionit sipas kërkesave në shtojcën VIII.

4. Për qëllimet e kategorive O1, O2, O3 dhe O4:

Një “tip” përbëhet nga mjetet që nuk ndryshojnë në të paktën aspektet thelbësore të mëposhtme:

- prodhuesi;
- përcaktimi i tipit të prodhuesit;
- kategoria;
- aspekte thelbësore të ndërtimit dhe dizenjës;
- shasi/trup vetëmbajtës, (ndryshime të dukshme dhe themelore);
- numri i akseve;
- rimorkio me binar/gjysmërimorkio/rimorkio me aks qendre,
- Tipi i sistemit të frenave (p.sh., pa frena/inerci/fuqi).

“Variant” i një tipi janë mjetet brenda një tipi që nuk ndryshojnë në të paktën aspektet thelbësore të mëposhtme:

- faza e ndërtimit (p.sh., e kompletuar/e pakompletuar);
- stili i trupit (p.sh., rimorkio rulotë/platformë/autobot) (vetëm për mjetet e përfunduara/kompletuara);
- diferencat e masës së ngarkesës maksimale teknikisht të lejueshme prej më shumë se 20% (më e larta është më shumë se 1,2 herë më shumë se më e ulëta);
- akset e drejtimit (numri dhe pozicioni).

“Versioni” i një varianti janë mjetet që përbëhen nga një kombinim i artikujve të treguar në paketën e informacionit.

5. Për të gjitha kategoritë:

Identifikimi i plotë i mjetit vetëm nga përcaktimet e tipit, variantit dhe versionit duhet të jenë në pajtim me përkufizimin e vetëm dhe të saktë të të gjitha karakteristikave teknike që kërkohen për mjetin të futet në shërbim.

C. PËRKUFIZIMI I TIPIT TË TRUPIT (vetëm për mjetet e përfunduara/kompletuara)

Tipi i trupit në shtojcën I, shtojca III, pjesa 1, pika 9,1 dhe në shtojcën IX, pika 37 tregohet nga kodifikimi i mëposhtëm:

1. Autoveturat e pasagjerëve (M1)

AA Limuzinë standardi ISO 3833-1977, përkufizimi nr.3.1.1.1, por duke përfshirë edhe mjetet me më shumë se katër dritare anash.

AB Autoveturë me pesë dyer limuzinë (AA) me një derë në fund të mjetit.

AC Mjet me portobagazh standardi ISO 3833-1977, përkufizimi nr.3.1.1.4 (mjet me portobagazh)

AD Mjet me dy dyer standardi ISO 3833-1977, përkufizimi nr.3.1.1.5

AE I konvertueshëm standardi ISO 3833-1977, përkufizimi nr.3.1.1.6

AF Mjet me shumë qëllime mjet motorik i ndryshëm nga ata të përmendur në AA deri AE të destinuar për të transportuar pasagjerë dhe bagazhin ose mallrat e tyre në të njëjtin ambient. Megjithatë, nëse ky mjet përmbush të dy kushtet e mëposhtme:

(i) numri i ndenjësive, duke përfshirë shoferin, nuk është më shumë se gjashtë;

një “pozicion uljeje” konsiderohet si ekzistues nëse mjeti është i pajisur me mjete fiksime ndenjëseje të përdorshme;

“të përdorshme” janë ato mjete fiksime që mund të përdoren. Me qëllim që mjetet e fiksimit të bëhen të papërdorshme, prodhuesi pengon përdorimin e tyre, p.sh., duke salduar mbi to pllaka mbulimi ose duke vendosur sende të tjera të ngjashme dhe të përhershme që nuk mund të hiqen duke përdorur veglat normalisht të disponueshme të punës; dhe

(ii) $P - (M + N \times 68) > N \times 68$

Ku:

P = masa e ngarkesës teknikisht e lejueshme në kg,

M = masa në gjendje funksionale në kg

N = numri i pozicioneve për ulje duke përfshirë shoferin. Ky mjet nuk konsiderohet si mjet i kategorisë M1.

2. Mjete motorike të kategorisë M2 or M3

Mjete të klasës I (shih direktivën 2001/85/KE)

CA Një bord

CB Dy borde
 CC Një bord fizarmonikë
 CD Dy borde fizarmonikë
 CE Një bord me dysHEME të ulët
 CF Dy borde me dysHEME të ulët
 CG Një bord me dysHEME të ulët fizarmonikë
 CH Dy borde me dysHEME të ulët fizarmonikë
 Mjete të klasës II (shih direktivën 2001/85/KE)
 CI Një bord
 CJ Dy borde
 CK Një bord fizarmonikë
 CL Dy borde fizarmonikë
 CM Një bord me dysHEME të ulët
 CN Dy borde me dysHEME të ulët
 CO Një bord me dysHEME të ulët fizarmonikë
 CP Dy bord me dysHEME të ulët fizarmonikë
 Mjete të klasës III (shih direktivën 2001/85/KE)
 CQ Një bord
 CR Dy borde
 CS Një bord fizarmonikë
 CT Dy borde fizarmonikë
 Mjete të klasës A (shih direktivën 2001/85/KE)
 CU Një bord
 CV Një bord me dysHEME të ulët
 Mjete të klasës B (shih direktivën 2001/85/KE)
 CW Një bord

3. Mjete motorike të kategorisë N

BA Kamion shih direktivën 97/27/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të 22 korrikut 1997 në lidhje me masat dhe dimensionet e disa kategorive të mjeteve motorike dhe rimorkiove të tyre [2] shtojca I pika 2.1.1

BB Furgon-kamion me kabinë të integruar në trup

BC Mjet për tërheqjen e shih direktivën 97/27/KE shtojca I pika 2.1.1 gjysmërimorkiove

BD Mjet për tërheqjen e shih direktivën 97/27/KE shtojca I pika 2.1.1 rimorkiove (traktorë rruge)

- Megjithatë, nëse një mjet i përkufizuar si BB me një masë maksimale teknikisht të lejueshme që nuk kalon 3500 kg:

- ka më shumë se 6 pozicione uljeje duke përjashtuar shoferin;
ose

- përmbush të dy kushtet e mëposhtme:

(i) numri i pozicioneve të uljes, duke përfshirë shoferin, nuk është më shumë se 6 dhe

(ii) $P - (M + N \times 68) \leq N \times 68$

ky mjet nuk konsiderohet të jetë mjet i kategorisë N.

- Megjithatë, nëse një mjet i përkufizuar si BA, BB me një masë maksimale teknikisht të lejueshme që kalon 3500 kg, BC ose BD përmbush të paktën një nga kushtet e mëposhtme:

(i) numri i pozicioneve të uljes, duke përfshirë shoferin, nuk është më shumë se 8 ose

(ii) $P - (M + N \times 68) \leq N \times 68$

ky mjet nuk konsiderohet si mjet i kategorisë N.

Shih pjesën C, pikat e këtij, shtojca për përkufizimet e “pozicioneve të uljes”, P, M dhe N.

4. Mjetet e kategorive O

DA Gjysmërimorkio shih direktivën 97/27/KE shtojca I pika 2.2.2

DB Rimorkio me binar shih direktivën 97/27/ KE shtojca I pika 2.2.3

DC Rimorkio me aks qendre shih direktivën 97/27/ KE shtojca I pika 2.2.4

5. Mjete për qëllime të veçanta

- SA Autorulotë (shih shtojcën II A, pika 5.1)
- SB Mjete të blinduara (shih shtojcën II A, pika 5.2)
- SC Ambulanca (shih shtojcën II A, pika 5.3)
- SD Mjete funerali (shih shtojcën II A, pika 5.4)
- SE Rimorkio rulotë (shih shtojcën II A, pika 5.6)
- SF Vinça të lëvizshëm (shih shtojcën II A, pika 5.7)
- SG Mjete të tjera për qëllime të veçanta (shih shtojcën II A, pika 5.8)
- SH Mjete të përshtatshme për karrige me rrota (shih shtojcën II A, pika 5.5)

SHTOJCA III

LISTA E PLOTË E INFORMACIONIT PËR QËLLIMIN E MIRATIMIT TË TIPIT KE TË MJETEVE (Për shënime shpjeguese, jeni të lutur t'i referoheni faqes së fundit të shtojcës I)

PJESA I

Informacioni i mëposhtëm, sipas rastit, duhet të jepet në tri kopje dhe të përfshijë një listë të përmbajtjes. Çdo skicë duhet të jepet në shkallën e duhur dhe me hollësi të mjaftueshme në një format A4 ose të palosur në një format A4. Nëse ka fotografi, këto duhet të tregojnë hollësi të mjaftueshme.

Nëse sistemet, pjesët përbërëse, njësitë e veçanta teknike kanë kontrolle elektronike, duhet të jepet informacioni në lidhje me funksionimin e tyre.

A: Për kategoritë M dhe N

0. TË PËRGJITHSHME

0.1 Marka e fabrikës, emri i prodhuesit:

0.2 Tipi: ...

0.2.1 Emër(a) tregtar(ë) (sipas rastit):

0.3 Mjetet e identifikimit të tipit, nëse shënohet në mjet (b): ...

0.3.1 Vendndodhja e atij shënimi: ...

0.4 Kategoria e mjetit (c):

0.4.1 Klasifikimi(et) sipas mallrave të rrezikshëm që mjeti është i destinuar të transportojë:

0.5 Emri dhe adresa e prodhuesit: ...

0.8 Adresa(t) e fabrikës(ave) të montimit:

0.9 Emri dhe adresa e përfaqësuesit të prodhuesit (sipas rastit):

1. KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME TË NDËRTIMIT TË MJETIT

1.1 Fotografi dhe/ose skica të një mjeti përfaqësues:

1.3 Numri i akseve dhe rrotave:

1.3.2 Numri dhe pozicioni i akseve të drejtimit:

1.3.3 Akset aktive (numri, pozicioni, ndërlidhja):

1.4 Shasia (sipas rastit) (skicë e përgjithshme):

1.6 Pozicioni dhe vendosja e motorit:

1.8 Krahu i drejtimit: majtas/djathtas (1).

1.8.1 Mjet i pajisur për t'u drejtuar në trafikun e krahut të djathtë/majtë (1).

2. MASAT DHE DIMENSIONET (e) (në kg dhe mm) (referojuni skicës sipas rastit)

2.1 Baza(t) e rrotave (me peshë të plotë) (f):

2.3.1 Gjurma e secilit aks të drejtimit (i):

2.3.2 Gjurma e të gjitha akseve të tjera (i):

2.4 Gama e dimensioneve të mjetit (e përgjithshme)

2.4.2 Për shasinë me trupin

2.4.2.1 Gjatësia (j):

2.4.2.1.1 Gjatësia e zonës së ngarkesës:

2.4.2.2 Gjerësia (k):

2.4.2.2.1 Trashësia e mureve (në rastin e mjeteve të destinuara për transportin e mallrave në temperaturë të kontrolluar):

2.4.2.2.3 Lartësia (në gjendje funksionale) (l) (për varjet e regjistrueshme për lartësinë, tregoni pozicionin normal të funksionimit):

2.6 Masa e mjetit me trup dhe, në rastin e një mjeti rimorkiues të kategorisë së ndryshme nga M1, me instrumentin e takimit, nëse është instaluar nga prodhuesi, në gjendje funksionale, ose masa e shasisë ose shasisë me kabinë, pa trup dhe/ose instrument takimi nëse prodhuesi nuk ka instaluar trupin dhe/ose instrumentin e takimit (duke përfshirë, tretësit, veglat, gomën rezervë, nëse është instaluar dhe shoferin dhe, për autobusët, një personel ekuipazhi nëse ka një vend për ekuipazhin në mjet (o) (maksimumi dhe minimumi për çdo variant):

2.6.1 Shpërndarja e kësaj mase ndërmjet akseve dhe, në rastin e një gjysmërimorkioje ose rimorkioje me aks qendror, ngarkesa në pikën e takimit (maksimumi dhe minimumi për çdo variant):

2.7 Masa minimale e mjetit të kompletuar të deklaruar nga prodhuesi, në rastin e një mjeti të pakompletuar:

